



Moduli 1.....	2
Çfarë është punëtorja?	2
Arsimi dhe demokracia	7
Pjesëmarrja e nxënësve. Mundësia për zgjedhje	10
Pavarësia dhe individualizimi në procesin e mësimdhënies nëpërmjet lidhjes	14
Stilet e të mësuarit	15
Mësimi interaktiv nëpërmjet parashtrimit të pyetjeve. Taksonomia e Blumit	15
Qasja integruese. Proektet e nxënësve	19
Punimi i planit grupor dhe individual për përcjelljen proekteve të nxënësve-portfolio	26
Moduli 2.....	27
Përparimi i shëndetit në shkollë	27
Shëndeti mental dhe emocional.....	31
Fëmijët me “sjellje ekstreme”. Ndhma e nxënësve për shprehjen e emocioneve ..	31
Dëgjimi aktiv	34
Pasqyra për vetveten dhe vetbesimi në procesin mësimor.....	34
Krizat zhvillimore gjatë fëmijëris dhe adoleshencës. Karakteristikat dhe potenciali	35
Nevojat e nxënësve në shkollë	37
Komponenta multikulturore në procesin mësimor - respektimi i dallimeve dhe ngjajshmërive	46
Promovimi i integritit. Percepioni i tjetrit	47
Gjeneralizimet dhe stereotipet.....	49
Paragjikimet dhe diskriminimi	49
Konfliktet.....	53



Moduli 1

Ora-punëtori

Modernizimi i mësimdhënies në thelb nënkuptojmë mësimdhënien aktive/interaktive, në të cilën të gjithë nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në realizimin e orës. Përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në krijimin dhe zbatimin e ndryshimeve radikale në realizimin e orës, ndryshon rolin, përgjegjësinë dhe pozitën e mësimdhënësve dhe nxënësve. Ora mësimore e realizuar në këtë mënyrë është e orientuar ka procesi, ndërlidhja, bashkëpunimi.... Atmosfera që krijohet është iniciuese, pozitive dhe e sigurtë, njëkohësisht mundëson liri në të shprehur dhe zhvillim. Mësimi bashkëkohor për çdo orë mësimore mund të jetë në një farë mënyre punëtori në vete.

Çfarë është punëtorja?

Një ose më tepër aktivitete që janë realizuar në grupe, të bashkuar rreth një teme. Tema mund të jetë e paracaktuar ose të zhvillohet gjatë punorisë.

Shmbulli 1: Punëtori me temë: Enët e gjakut; Rinia dhe pirja e duhanit; Zgjedhja e konfliktit; Rrafshi dhe trekëndëshi etj.

Shmbulli 2:” Formoni 6 grupe me nga 4 anëtar. Ndëgjoni problemin që do ta prezantoj! Mundohuni së bashku për të gjetur më shumë zgjidhje!. Nuk ka zgjidhje të mira dhe të këqija... ”

Punëtorja gjithmonë ka një strukturë që mund të jetë e ngurtë ose më fleksibël. Struktura të ngurta kanë ato punëtori që kanë rezultatet e parashikuara dhe të përkufizuara qartë pjesët: hyrja / adaptimi /, pjesë qendrore / aktiviteti kryesor / dhe përfundimi / komentet dhe konkluzionet /.

Struktura fleksibile kanë ato punëtori që mbështeten në ndërtimin e marrëdhënieve në mes anëtarëve të grupit, duke përdorur shprehjet themelore - loja, fjala dhe aktivitete të përbashkëta. Në këto punëtori, ndërveprimi njerëzor shihet si bazë e të mësuarit dhe zhvillimit. Gjatë kësaj dallimet jo vetëm që respektohen, por edhe trajtohen edhe si pasuri njerëzore prej së cilës thithen ide dhe aktivitete të reja. Me zmadhimin e fleksibilitetit të strukturës, punëtorja më tepër drejtohet kah vetë procesi. Rezultati është më pakë i rëndësishëm, gjegjësisht vëmendja nuk është e orientuar kah rezultati paraprak i pritur. Në çdo rast nuk ka përgjigje të sakta dhe jo të sakta të pyetjeve të parashtruara; çfardo orvatje ose përgjigje është origjinale, për arsye se ka rëndësi të veçantë, e cila njëkohësisht është edhe personale, ndërlidhje, gjithashtu edhe zhvillimore.

Qëllimi kryesor i çdo seminar është për të nxitur të mësuarit dhe zhvillimin në kuptim më të gjerë.

Pyetjet dhe kërkesat (pritjet) janë nxitësit e procesit të punorisë dhe aktivizojnë punën në grupe. Ata mund të inicohen nga mësuesit ose nga nxënësit.

Shmbulli 1: "Çfarë u vjen në mendje kur dëgjoni fjalën lojë?"

Shmbulli 2: "Në seminar dua / nuk dua të ndodhë ..."

Çfarë mund të pritjet si arritje? Liria e mendimit dhe e fjalës, lidhjen dhe cilësinë e re të përvojës, kreativiteti dhe mundësitë për rritjen e zgjedhjes ...



Puntoria si një formë e të mësuarit-aktiv metodë e të mësuarit experencial

Në kushtet e atmosferës nxitëse, të sigurt dhe kooperative nxënësit në punëtori kanë mundësi të jenë të përfshirë në mënyrë **aktive** gjatë gjithë procesit, nëpërmjet: shoqatave, duke propozuar ide, parashtrim të pyetjeve, duke dhënë përgjigje, zgjidhjeve të problemeve, gjegjësishtë me vizatime, shkrim, lëvizje, dramatizim, lojra etj.

Në punëtori sigurohen kushtet që **komunikimi** të rjedhë lirshëm në mes pjesëmarrësve, duke e përfshirë edhe mësuesin. Një tregim duhet të inicoj tregimin tjetër, pyetjet ose idenë. Më këtë krijohen kushte për këmbimin e diturive dhe eksperiencës. Këmbimi inicohet me aplikimin e teknikave të ndryshme të punës në grupe: nxënësit mund të bisedojnë ose ti tregojnë eksperiencat e veta në çifte, në grupe më të vogla ose në tërë grupin. Në këtë mënyrë nxënësve u jepet liri e plotë dhe më tepër mundësi për punën, ndërlihdjen dhe shkëmbimin: në mënyrë simbolike (nëpërmjet zërit, fjalës, vizatimit, lëvizjes, lojës), direkt (duke folur për ndjenjat dhe përvojën personale), indirekte (duke dëgjuar ndërlihdet me përvojat e të tjerëve).

Ndërveprimi (kooperimi) - "ekipet për mësim"

Në procesin e punëtoris zgjedhja e aktiviteteve mundëson komunikim në mes pjesëmarrësve, bashkëpunim, hulumtim të përbashkët, plotësim, etj., që krijon kushte për pjesëmarrje të barabartë dhe marrje të vendimeve. Rezultati i përfituar nuk vlerësohet, kritikohet ose ndryshohet, por shfrytëzohet në vazhdimësi, si inicues i fazës së ardhshme ose temës së punëtorisë. Ndërveprimi (kooperativiteti) dhe bashkëpunimi sigurojnë kontinuitet në mësim dhe zhvillim, i cili është i rëndësishëm për qendrueshmërin e zhvillimit, pa mar parasyshtë intenzitetin e ndryshimeve në të cilat nuk marim pjesë.

Mësimi sipas modelit

Me mënyrën e udhëheqjes dhe sjelljes në punëtori, mësuesi paraqet burim të rëndësishëm për mësim. Përveç zgjedhjes së metodave dhe teknikave me të cilat zhvillohet aktiviteti, me rëndësi është edhe përmbajtja, sjellja dhe stili i udhëheqjes së punëtorisë. Nxënësit vërejnë si udhëheqësi i përkushton kujdes, komunikon, tregon respekt, propozon ide, gjenë zgjidhje....

Mësimi nëpërmjet lojës

Për të gjithë llojet e punëtorisë është karakteristike se pjesa më e madhe e aktiviteteve zhvillohet nëpërmjet lojës. Gjatë kësaj, loja kuptohet si punë serioze të cilën nxënësit dhe mësuesi e bëjnë në procesin e mësimin dhe zhvillimit. Në lojë provohen role të ndryshme (hulumtues, prezentues, inicues, analizues, fëmijë, i ritur, ..) nëpërmjet të cilave mësojm atë që nuk e dijmë dhe kalojmë një hap përpara në zonën e zhvillimit të ardhshëm. Me lojën e ndjeshme atë që duhet të arrijë. Në lojë nxënësi është për një kokë më i lartë se vetja. Në lojë edhe mësuesi mund të jetë për një kokë më i lartë se vetja. Në lojë ka mundësi që fëmija të jetë për një kokë më i lartë se i rituri.



Këshilla praktik për “udhëheqjen neutrale” të punëroëve:

Më sjelljen tuaj dhe fjalimin mund të tregoni se gjithë përgjigjet dhe eksperiencat e ndryshme janë të pranura në mënyrë të barabartë. Kur përjetimi i dikujt nuk përputhet me këndvështrimin tënd ose pritjet, mundohuni që ta shihni si pjesë e dallimeve të përgjithëshme që ekzistojnë në mes njerëzve, pa u munduar që të korigjoni ose komentoni. Ekzistimi i mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme në grup është evidencë për besimin dhe lirinë e mendimit dhe fjalës, me të cilat fillon mësimi dhe zhvillimi. E njëjta vlenë edhe kur dëgjoni diçka që është në pajtim me besimin dhe qëndrimin tuaj. Aprovimi si dhe mohimi mund të ndal procesin e hapjes dhe shprehjes së mendimeve të ndryshme. Vërtetoni nëse dikush ka mendim të ndryshëm dhe iniconi për shprehjen e tij: “A mendon dikush ndryshe?” Çdo mendim dëgjoni me vëmendje dhe me falënderim, me fjalët “Në rregull”, “Mirë” ose me aprovim jo-verbal. Mund të aprovi edhe atëherë kur nuk pajtoheni, ose nuk e aprovi. Kjo është me rëndësi kur punoni me nxënës, veprimet e të cilëve nuk i aprovi, por në të njëjtën kohë mund ta bëni me dije se vetë nxënësi dhe ajo që deklaron e pranoi si mendim personal të tij.

Nxënësit në kulturën tradicionale, posaçërisht në arsim, janë të pregaditur të japin përgjigjet që mësuesit e presin dhe e aprovojnë. Pyetjet që fillojnë me “A ka... “ më së shpeshti mbarojnë me po/jo përgjigje, duke i inkurajuar përgjigjet e dëshiruara të nxënësit. Kur dëshirojmë të diskutojmë për ndonjë temë me nxënësit, më të përshtatshme janë pyetjet të cilat fillojnë me fjalët; çfarë, si dhe në çfarë mënyre Pyetjet e këtilla parashtrohen dhe përgjegjen në grupe, gjatë të cilës nxënësit dhe mësuesit kanë një rol të barabartë për të gjetur përgjigje.





Puntori për njohftim dhe për lidhje

Qëllimet:

- Formimi i grupit;
- Formimi i atmosferës së sigurtë, inicuese dhe kooperative në grup;
- Vetëvërtetimi;
- Diskutimi për pritjet; dhe
- Formimi i rregullave grupore.

Materialet:

- Stema personale (fleta për punë);
- Dëshiroj të.... (fletë për punë);
- Fletë e madhe letre, markerë, flomasterë, lapsa ose stilografa; dhe
- Fletë e thyer në tre pjesë me vizatime të jashtme (Fletë për punë).

Aktivitete:

1. Njohftim - Loja me emra: Secili pjesëmarës në grup e tregon emrin dhe mbiemrin. Pastaj, pjesëmarësit e thonë emrin e tyre me zë të lartë, qetë, në bazë të melodisë, e ndajnë në rokje dhe krijojnë emër të ri me lidhjen e rokjeve të emrit të pjesëmarësit tjetër. Në rrethin e fundit secili pjesëmarës zgjedhë mënyrën si do ta thekson emrin e tij.

Stema personale: Secili pjesëmarës merë një fletë të letrës me stemë të zbrazët. Në sejcilën pjesë të stemës duhet të shënon dhe vizaton diçka për vetën e tij: Çfarë bën në kohën e lirë? Çfarë të plotëson në punë? Çfarë dëshiron të arrishë? Diçka për familjen tënde.... Në pjesën e zbrazët ndër stemën shënohet motoja jetësore, ndonjë proverbë, urtësi, fjali e dashur, frazë. Pastaj pjesëmarësit mund ta tregojnë stemën personale dhe të ndajnë atë që e kanë shkruajtur me tjerët në grupe ose çifte, pastaj një çift të prezentoj për çiftin tjetër për atë që ka dëgjuar.

Varijacionet për njohftim dhe vetëvërtetim: Dëshiroj që ... Secili merë nga një fletë në të cilën është vizatuar silueta dhe katër mjegulla për rreth. Secili pjesëmarës e plotëson vizatimin dhe e ngjyrosë siluetën në atë mënyrë që ajo do të bëhet silueta e tij, gjejësisht njeri. Pasi e mbarojnë këtë u jepet instruksione në mjegullat të shënojnë:

- Çfarë dëshirojnë sytë e mi të shikojn;
- Çfarë dëshirojnë veshët e mi të dëgjojn;
- Çfarë dëshirojnë duart e mia të bëjnë; dhe
- Çfarë dëshirojnë këmbët e mia të bëjnë.

2. Pritjet dhe rregullat: Në fletë të madhe prej letre shënohen pritjet e grupit. Pastaj diskutohet për pritjet, cilat prej tyre janë të realizueshme, cilat nuk janë, prej kujt varet realizimi dhe kështu me radhë. Më rëndësi është që në fund të trajnimit përsëri të kthehemi në pritjet dhe të diskutohet a janë realizuar ato.



Prej fletës së pritjeve rrjedhin dhe **rregullat themelore për punë në grup** të cilat mund të shënohen dhe të plotësohen.

Në fillim të pjesës punuese mirë është që grupi të njihet me qëllimet, me temat dhe me aktivitetet të parapara me program. Diskutohet edhe për organizimet tjera të parapara me program, si p.sh paizat, sa do të zgjasin, çfarë ofrohet nga organizatori, etj.

3. Lidhja me tregimin: Pjesëmarësit ndahen në trijada. Sejcila trijadë merë fletë të thyer në tre pjesë, sejcila pjesë ka vizatim në pjesën e jashtme (vija të drejta, të thyera, të mbyllura dhe të hapura). Sejcili prej tijadës përfundon njërin nga vizatimet, pastaj bëhet tregimi për vizatimet i atij tjetrit. Prej tre tregimeve krijohet një i përbashkët, të cilit i caktohet titull the emir i autorit-kombinimi i rokjeve nga emrat e pjesëmarësve në trijadë.





Arsimi dhe demokracija

Demokracia është ideal i shumë shoqërive moderne. Nënkupton integrimin dhe jetën e bazuar në disa principe: për liri, pjesëmarrje dhe barazi.

Demokracia në shkolla ose demokratizimi i shkollave, gjithashtu, paraqet ideal në shoqërinë tonë moderne. Megjithatë, demokratizimi i shkollave është proces i cili zhvillohet dhe nëpër të cilin kalojnë të gjithë shkollat që si qëllim kanë vendosur ndërtimin e shkollës demokratike. Demokratizimi i shkollave nënkupton ndryshimin e shumë sferave të funksionimit, duke filluar prej ndryshimit të mënyrës së organizimit të aktiviteteve, nëpërmjet ndryshimit të qasjes dhe principeve të punës, pastaj mënyrat e kyçjes së anëtarve të shoqërisë, mënyrat e vendim-marjes, gjegjësisht distribuimin e pushtetit.... Ndryshimet nuk ndodhin brenda natës, posaçërisht nëse miret parsyshë konteksti historik dhe kulturor dhe fakti që çdoherë shkolla ka qenë hierarkike, autokratike dhe totalitare. Megjithatë, sotë kur në mënyrë deklarative dhe në mënyrë normative jetojmë në shoqëri demokratike të gjithë jemi të involvuar në procesin e arsimit, e mbajmë përgjegjësin për kontributin e demokracisë në arsim. Që don të thotë ekziston përgjegjësi kolektive dhe personale sa do të afrohem i idealit për shkollë demokratike.

Ku dallohen shkollat demokratike prej atyre tradicionale?

Pushteti në shkollat demokratike është disperzuar (shpërndar) edhe në procesin e vendim-marjes marim pjesë të gjithë anëtarët e shkollës: drejtorja, mësuesit, nxënësit, deri sa në shkollat tradicionale pushteti është i centralizuar dhe ekziston vendosje hierarkike; drejtori vendos më së shpeshti për të gjithë aktivitetet në shkollë, mësuesi më së shpeshti vendosë në klasë, ministria vendosë për rregullat e lojës të të gjithë shkollave....

Mardhëniet ndaj diturisë, gjithashtu, është komplet i ndryshëm. Në shkollat demokratike dituritë arrihen nga më tepër burime, është multidimensionale, multidisciplinare, me të cilën nxënësit i mundësohet të kupton kompleksitetin e të gjithë dukurive, gjendjeve, gjërat që i mëson për botën dhe njeriun. Dituritë nuk janë të kufizuara dhe njëanëshme. Arsimi demokratik mundohet të zhvillon rëndësi personale për diturit, që don të thotë informacionet, gjegjësisht të zhvillon mendim kritik dhe kreativ dhe qasje aktive ndaj mesit dhe ndaj vetëvetës. Përkundër kësaj, në shkollat tradicionale nxënësit mësojnë mekanikisht me memorimin e fakteve, të cilët janë paraqitur si të vërteta të vetme, të izoluara dhe distancuar nga praktika.

Qëllimet e mësimin në shkollat demokratike janë të drejtuar kah zhvillimi i qendrimit kritik, ka humltime, kah kreativiteti, pastaj kah zhvillimi i ndjenjës për tjetrin nëpërmjet promovimit të vlerave për tolerancë dhe pranim, dhe në përgjithësi kah procesi i përhershëm dhe pa kufi të zhvillimit. Shkollat tradicionale janë të drejtuara drejtë absorbimit të diturive të gatëshme, memorizimi, promovimi dhe uniformitetit, konformizmit dhe moralizimit, q.d.th. formimi i individit sipas mostrës paraprakisht të paramenduar.

Mësuesi në shkollat demokratike udhëheq, ndihmon, koordinon, drejton, përcjellë, deri sa në shkollat tradicionale ligjiron, dicitlinon dhe vlerëson.



Nxënësi është aktiv, i lirë në shprehje, kurioz - **ka rol qendror** përkundër nxënësit në shkollën tradicionale ku ai është pasiv, pa eksperiencë, jo-kreativ.

Në realitet nuk ekzistojn shkolla plotësisht demokratike ose plotësisht autokratike. Këto dy përshkrime i tregojn ekstremet e një kontinuiteti dhe tendencat të cilat mbizotrojnë në disa shkolla.

Pse është e rëndësishme demokracia në shkollë?

Demokracia në shkollë është e rëndësishme për këto arsye:

- Zhvillimi i ndjenjës për përgjegjësi;
- Ndjenja për bashkëpunim dhe bashkësi;
- Inicim të pjesëmarrjes dhe arritje të përvojës për udhëheqje me përgjegjësi;
- Vendim-marje dhe zgjedhje për jetën personale dhe jetën e shoqërisë;
- Zhvillimi i shkathtësive shoqërore, zhvillimi i mendimit kritik dhe kreativitetit;
- Zhvillimi i ndieshmërisë për nevojat e veta autentike dhe nevojat e të tjerëve; dhe
- Respektimi dhe pranimi i dallimeve....

Ndërtimi i shkollës demokratike mund të fillon me bisedë, sepse dialogu është një ndër parakushtet kryesore për zhvillim. Biseda mund të jetë për domethënien e demokracisë, definimit ose formësimin e vizionit, prej personales kah e përbashkëta. Baza e shkollës demokratike duhet të jetë pjesëmarrja e të gjithë anëtarve të shkollës në të gjithë segmentet e funksionimit të saj.

Si mund të implementohen principet themelore demokratike në shkollë?

Një prej mënyrave mund të jetë nëpërmjet mënyrës së organizimit dhe sigurimit të pjesëmarrjes e të gjithë pjesëmarrësve në ndërtimin e bashkësisë së shkollës.

Për shembull në nivel të shkollës mund të:

- Caktohen dhe zhvillohen procedura dhe principe për gjithë aspektet e funksionimit të shkollës - mënyra e vendim-marjes, zgjedhja, sjellja dhe veshja, zgjedhja e situatave konfliktuoze, ushqimi, pirja e duhanit, sjellje tjera, mungesat... të cilat i mbrojnë dhe i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore njerzore;
- Kyçen nxënës në procesin e vendim-marjes, procedura dhe rregulla nëpërmjet kyçjes së nxënësve në format ekzistuese, trupa, të cilët marim vendime.
- Formohen këshilla/trupa të nxënësve të cilat kanë ndikim në vendimet dhe marim pjesë në ndërtimin e procedurave të shkollës;
- Formohen grupe të ndryshme përgjegjëse për aspekte të ndryshme në të cilët marim pjesë aktive dhe organizohen nxënësit, psh.: grupi për zgjedhjen e konflikteve, grupi për zgjedhjen e situatave kritike, grupi që meret me sjelljet riskante, arogancën, mungesat, ushqimin, ekskurzionet dhe shëtitjet



- Siguroj pjesëmarje aktive të nxënësve në organizimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve të lira: sekcione, projekte, ngjarje, solemnitete, e kështu me radhë; dhe të
- Bëhen programet për zhvillimin e vlerave multikulturale, integritit, pranimit dhe promovimit të dallimeve.

Menaxhimi i klasës demokratike

Menaxhimi në klasë ka të bëjë me mënyrën e organizimit, udhëheqjen dhe funksionimin e klasës/orës. Mësuesit më së shpeshti e shfrytëzojnë këtë term kur flitet për preventivë nga sjelljet problematike të nxënësve. Menaxhimi në klasë është aspekti më i vështirë për mesimdhënje për shumë mësues. Menaxhimi në klasë është i lidhur me motivimin, disiplinën dhe respektin. Menaxhmenti i suksesshëm mundëson edhe mësuesi edhe nxënësi të ndihen të suksesshëm dhe të përdorshëm në klasë. Komponenta kyçe për menaxhment të suksesshëm në klasë është mësimi, dizajnimi dhe aplikimi i procedurave. Këto janë disa propozime për menaxhim të suksesshëm në klasë të cilët kanë të bëjnë me organizimin dhe udhëheqjen:

- Zhvillim të përbashkët (vendosje, testim, ndryshim) rregulla për punën në klasë;
- Diskutimi dhe pranimi i çdo mendimi për tema të ndryshme prej mësimit dhe jetës të nxënësve, mësuesve dhe në përgjithësi ne shkollë: dhe
- Vendim-marje të përbashkët për aspekte të ndryshme nga jeta e përbashkët me shfrytëzimin e procedurave demokratike (konsezusit, votimit, zgjedhje e rastit ..)

Në lidhje me disiplinën dhe menaxhimi me emocione të ndryshme dhe nevojat e nxënësve në doracakun në pjesën e dytë janë të ofruar disa puntori dhe modele teorike të cilët mund të shfrytëzohen për menaxhimin në klasë.





Pjesëmarja e nxënësve. Mundësia për zgjedhje

Komponenta më themelore dhe më kryesore e demokracisë është pjesëmarja. Mund të ketë mënyra të ndryshme me të cilat sigurohet pjesëmarja në shoqëri. Për sh., pjesëmarja në aktivitete grupore, pastaj pjesëmarja si interaktivitet ose lojë në metodat e mësimit, pjesëmarja në debate dhe diskutime, pjesëmarja në shpërndarjen e pushtetit, vendim-marje.

Ekziston e ashtuquajtura pjesëmarje autentike me të cilën nënkuptojmë refleksionin e fakteve të cilët mësohen, kompleksiteti i tyre, ndërlidhshmëria, ndërvarësia, mendimi kritik dhe zhvillimi i diturive personale për faktet dhe informacionet, vendim-sjellje me përgjegjësi dhe ndërmarrja e akcioneve në kontekst. Kjo pjesëmarje mundëson të zhvillohen pavarësia dhe autonomia e nxënësve dhe potenciali për zgjedhjen e ndikimeve komplekse në jetën e tyre dhe më gjërë.

Sipas Roxher Hartit (Simovska dhe Unkovska, 1998) pjesëmarja është e drejtë themelore qytetare. Kuptimi i pjesëmarjes demokratike, gatishmëria dhe kompetenca për pjesëmarje mund të arrihen gradualisht dhe vetëm nëpërmjet praktikës. Ajo nuk mund të mësohet si abstrakcion. A mund që mësuesit të zhvillojnë pjesëmarje autentike për të cilën edhe ata vetë nuk kanë përvojë për pjesëmarjen autentike dhe nuk marrin pjesë në procesin e vendim-marjes? Me siguri është rëndë, por definitive është e mundëshme, si para kushtë për këtë është ridefinimi i pozicionit vetanak, roli dhe qasja ndaj punës, si dhe pranimi sfidës, gjegjësisht trimëria, besimi në potencialin e fëmijëve, gatishmëria për zgjedhjen e problemeve dhe barrierave në gjatë procesit, të hapur për të paqartën

Si të zhvillohen dhe praktikohen pjesëmarrjet aktive dhe autentike të nxënësve në shkollë? Njëra prej mënyrave me të cilën sigurohet pjesëmarja është mënyra e organizimit dhe ndarja e pushtetit, gjegjësisht ndarja e përgjegjësisë. Proektet e nxënësve (shiqo më poshtë SIVAP metoda për udhëheqjen e proekteve) janë korniza të mira për zhvillimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive dhe autentike të nxënësve. Pjesëmarja mund të praktikohet për çdo ditë dhe të zhvillohet gradualisht nëpërmjet dialogut dhe aktivitete të përbashkëta të anëtarve të shoqërisë.

Mundësia për zgjedhje është komponent me rëndësi në realizimin e parakushtit për ekzistimin e pjesëmarrjes autentike. Nxënësi duhet të mësojë si të zgjedh, të vëren mundësitë e ndryshme për zgjedhje, kjo është e mundëshme nëse ka mundësi për zgjedhje në jetën e përgjithshme dhe në mësim (të zgjedhë tema, të zgjedhë pjesë të procesit ku do të mer pjesë, të zgjedh metoda dhe teknika, të zgjedhë mënyrën dhe mjetet për t'u shprehur.....) Kjo eksperiencë e pjesëmarrjes aktive dhe autentike më vonë mundëson sjellje të përgjegjshme të vendimeve të cilët kanë të bëjnë me pyetjet më komplekse jetësore.



Puntoria për demokracinë

Qëllimet:

- Njohftimi me principet demokratike dhe mënyrat e implementimit të tyre në shkollë;
- Zhvillimi i vetëdijes dhe ndjeshmërisë për rëndësin e principeve demokratike, posaçërisht pjesëmarrjen e nxënësve në zhvillimin e demokracisë në shkollë; dhe
- Njohftimi me procedurat demokratike dhe vendim-marje (konsenzusin).

Materiale:

- Fletë të madhe prej letre, markerë, flomasterë, stilograf, lapsa;
- A4 dhe A3 letër;
- Hulumtimi i hënës (Fletë për punë); dhe
- Përgjigje e ushtrimit nga ana e NASA-ës (Fletë për punë).

Aktivitete:

1. **Stuhi me ide (mendime)** për demokracinë - inicimi i mendimit për temën. Në fletë të madhe prej letre shënohen asociacionet dhe idetë të cilat i thotë, spontanisht, secili nga grupi për temën demokraci. Kur do të shteren idetë parapara mund të diskutohet për kuptimin e disa termeve me qëllim që të zbulohen kuptimet e ndryshme. Në këtë mënyrë më tepër zhytëna në temë që përpunohet.

2. **Tregimet e përbashkëta (paraqitja kreative e demokracisë në shkollë):** Pjesëmarrësit ndahen në grupe prej 4 deri 5 antarësh. Grupet marrin instruksione të bisedojnë dhe të shkëmbejnë eksperiencë në lidhje me pyetjet: Si është demokracia në shkollën tonë? Si e zbatoj demokracinë në klasë?

Pastaj, pasi të shkëmbehen eksperiencat, fillojnë të bisedojnë dhe të zhvillojnë tregimin. Tregimi duhet të përmbanë këto elemente: personazhet, hyrjen, thurjen, përfundimin dhe nuk duhet të përfshijë një ngjarje; tregimi mund të konstruktohet prej eksperiencave të ndryshme. Në fund secili grup prezanton tregimin (mund të përfshihet edhe dramatizimi, nëse ka kushte) dhe e ngjet në hamer të madh i cili i përmban të gjithë tregimet që paraqesin demokracinë në shkollë.

Pas prezantimit mund të rrrjedhë **diskutimi ose debati**:

Diskutohet për atë çfarë është ideali/vizioni për demokracinë, dhe si është në realitet? Çfarë mungon? Çfarë mundet/duhet të ndryshohet?.. Prej tregimeve nënvizohen shembujt pozitiv dhe diskutohen propozime tjera për përmirësimin e gjendjes.

Pjesëmarrësit ndahen në çifte dhe duhet të shkruajnë arsyet në favor të qendrimeve pro dhe kontra në lidhje me pyetjen: A kontribuon demokracia mos respektimin e mësuesve nga nxënësit në shkollën tonë? Pasi të shkruajnë shkaqet çiftet bashkohen në grup prej katër antarësh dhe i krahasojnë. Pastaj, të gjithë të cilët besojnë se demokracia në shkollë **më të vërtet kontribuon** që nxënësit mos të respektojnë mësuesit shkojnë në anën e majtë, kurse ato të cilët besojnë se demokracia **më të vërtet nuk kontribuon** që nxënësit mos të respektojnë mësuesit në anën e djathtë. Të gjithë duhet të kenë qëndrim dhe të fillojë debati.



Në 7 deri 8 minutat e ardhëshme në të dy grupet pjesëmarrësit i shkëmbejn shkaqet në favor të qëndrimit tyre. Bashkarisht duhet të vendosin cilat shkaqe janë më të forta dhe të formulojnë listën, të cilën do ta shfrytëzojnë në mbrojtje të qëndrimit tyre para grupit tjetër. Pastaj, grupet zgjedhin përfaqësues i cili për 5 minuta do të prezanton qëndrimin e grupit. Pas pesë minutave fillon debati. Gjatë debatit duhet të respektohen këto rregulla: së pari të dëgjohet prezantimi pa u penguar, dhe së dyti, duhet të jetë i sjellshëm ndaj anëtarve të të dy grupeve. Debati zgjatë 12 minuta ku mund të flasin edhe nga dy anëtar të të dy grupeve, secili nga tre minuta. Si aktivitet final folësi i parë nga të dy grupet duhet të ketë një minutë deklaratë përfundimtare.

Variacion i tregimeve të përbashkëta mund të jetë teknika **rrotuluesja**. Në fleta të mdhaja prej letre shkruhen pyetjet: Si është demokracia në shkollën tonë? Si zbatohet demokracinë në klasë? Si mund ta zhvillojm demokracinë në shkollë? Pjesëmarrësit të ndarë në grupe diskutojnë për një pyetje dhe i shënojnë përgjigjet e mundëshme. Pastaj, grupet ndrohen në pyetjen e ardhëshme, në fletën tjetër. Në të njejtën mënyrë secili grup mendon, ndërton, diskuton dhe përgjigjet në të gjitha pyetjet. Para tërë grupit lexohen përgjigjet në të gjitha pyetjet.



3. Mapimi i pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësuesve në shkollë: Pjesëmarrësit në grupe vizatojnë hartën e shkollës (planin nga prespektiva e zogut) në të cilën i shënon me ngjyrë të caktuara vendet dhe ngjarjet ku marrin pjesë nxënësit. Me ngjyrë tjetër i shënojnë vendet dhe ngjarjet në të cilat nuk marrin pjesë nxënësit, kurse mendohet se është mirë të marrin pjesë. Pastaj zhvillohet diskutimi për pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve në vendim-marrjen në shkollë, në orë, gjatë pushimeve... pastaj, lloje të ndryshme të pjesëmarrjes dhe tregohet modeli i pjesëmarrjes autentike.



4. Hulumtimi i hënës - ushtrimi për konsenzus: Pjesëmarësit grupohen në grupe të vogla prej 4 deri 6 anëtar. Secili prej tyre merë një fletë me instruksione dhe laps. Është e nevojshme që të lexojnë problemin, të rangojnë çdo paragraf të mbijetesës, sipas renditjes së rëndësisë për ekipin që afrohet me fluturuesen amëz. Renditjet e tyre duhet ti shënojnë në kolonën “renditje e veçantë”. Për këtë kanë 15 minuta. Kur do të mbarojnë me rangimin e veçantë, fillon diskutimi për problemin në secilin grup. Anëtarët e secilit grup duhet të shkëmbejnë qendrimet e tyre “për” dhe “kundër”, si dhe të mundohen të arrijnë në konsenzus grupor për rangimin dhe të evidentojnë këtë si “konsenzus grupor”. Rrjedhin këshillat të cilët mund të ndihmojnë për arritjen e konsenzusit:

- Menjanoni diskutimet në lidhje me gjykimet personale. Qasuni detyrës në bazë të logjikës dhe pregadituni që të ndroni mendimin tuaj nëse anëtarët tjerë të grupit kanë argumente më të forta për ndonjë zgjedhje tjetër më logjike;
- Menjanoni rastet e ndryshimit të mendimit vetëm kur bëhet fjalë për pajtueshmëri dhe menjanoni konfliktet. Përbani vetëm ato zgjidhje me të cilat mund të pajtoheni vetëm pjesërisht;
- Menjanoni teknikat e “zvogëlimit të konflikteve”. Kështu për shembull: votimi në bazë të shumicës së votave, llogaritja e mesatarës ose tregëtimi gjatë vendim-marjes; dhe
- Kuptoni se dallimet në të menduarit janë të vlefshme, jo të dëmshme për procesin e vendim-marjes. Gjatë diskutimit të këtyre dallimeve mund të arrihet deri në ide të reja, megjithatë edhe në ide më të mira për zgjedhjen e problemit të përbashkët.

Kur të gjithë grupet mbarojnë me rangimin e tyre prezentohet lista e rangimit sipas NASA dhe diskutohet për këto pyetje: Cila anëtar i grupit kishte më tepër ndikim, kurse cili më pak? Cili ishte më tepër i vendosur për mbarëvatjen e bashkëpunimit në grup, kurse kush më pak? Vendimet a u sollën me konsenzus? A u paraqit ndjenja e kënaqësisë kur grupi punonte bashkarisht?



Pavarësia dhe individualizimi në procesin e mësimdhënies nëpërmjet lidhjes

Në “ Enciklopedinë pedagogjike” individualizimi në mësim definohet si princip didaktik që i obligon shkollat, mësuesit dhe qëllimet mësimore, përmbajtjet, metodat, mardhëniet dhe ndihmat në mësim të adaptohen ndaj dallimeve mes nxënësve dhe të orvaten që mësimin grupor t’a individualizojn dhe personalizojn më tepër, nxënësit t’i mundësohet mësim të pavarur dhe vetëiniciativ....” Ky definim nuk nënkupton se individualizimi dhe pavarësia paraqesin mësim të izoluar të secilit nxënës për vete, kurse më tepër nuk donë të thotë zhvillimin e vetëm një aftësie, shkathësie të fëmijëve. Mësimi i pavarur dhe i individualizuar duhet të ketë efektet e të mësuarit nëpërmjet lidhjes, gjegjësisht mësimi në relacionet me të riturin-mësuesin dhe nxënësit.. Spas Vigotskit, zhvillimi dhe mësimi nënkuptohen si aktivitet social i pandërprerë, gjegjësisht zhvillimi nuk ndodhë vetën në brendi të individues, por krijohet në relacionet sociale. Vigotski ka treguar se secili funksion psikologjik te fëmijët paraqitet dy herë: së pari në mes njerëzve (interpsikologjik), kurse pastaj në brendi të fëmijëve (intrapsikologjik). Ose sikurse thot Vigotski: mua nuk më intereson çfarë mund të bën vetë fëmija, mua më intereson çfarë mund të bën bashkarisht me mua. Që do të thotë, para se t’a individualizon atë që e mëson fëmija/njeriu gjendet në lidhje me tjetrin (me moshatarin dhe/ose me të riturin).

Nxënësi pavarësohet për arsye se nëpërmjet aktiviteteve fiton hapsirë dhe mundësi të luaj, të mendon, të lidhë, të krahason, të parashtrohet pyetje, të zgjedhë probleme, të transformon, të provon, të përformon, të prezanton.... E gjithë kjo ndodhë nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta me mësuesin dhe nxënësit. Nxënësi në mes tjerash e individualizon atë që e mëson, duke e mvetësuar procesin, por gjithë ashtu, edhe mësimi do të kujdeset për zhvillimin e potencialit individual nese dizajnon hapsirë dhe mundësi të nevojshme, provokacione dhe situata për provimin e roleve të reja, zhvillimi i shkathtësive të reja, stile kognitive, zhvillimin e aty aftësive të cilat i ka më të dobëta. Atëherë në vend të mësimit të izoluar të shkathtësive të nxënësit për të cilat është më i talentuar dhe për të cilat gjithmonë ekspozohet, i zhvillojm edhe aftësitë tjera të nxënësit në më tepër lëmi. Kuptohet, hapsira dhe mundësia e nxënësit të zgjedhë në cilat aktivitete do të marrë pjesë, në cilën fazë të procesit do të kyçet, gjithashtu mund të kontribuon për kujdesin e individualitetin të çdo nxënësi.





Stilet e të mësuarit

Nxënësit e ndryshëm “komentojnë” situata, aktivitete, detyra, informacione, në mënyrë të ndryshme, ky fenomen që quhet stil kognitiv ose stil i të mësuarit. Edhe mësuesit kanë stile kognitive të ndryshme, kurse zhvillimi e vetëdijes për stilin vetanak është aspekt i rëndësishëm në pregaditjen e punës me nxënës. Mungesa e vetëdijes për stilin kognitiv vetanak dhe për ekzistimin e stileve të ndryshme mund inicoj keqkuptime, deri në jotolerancë për stilet e nxënësve të cilët janë të ndryshëm nga stili jonë, si dhe etiketimi gabimisht i disa nxënësve si “të ndryshëm” ose “të ngadalshëm”. Për krahasim, hulumtimet tregojnë se dy hemisferat e trurit ndryshëm i përpunojnë informacionet: ana e djathtë funksionon në mënyrë globale, holistike, vizuale-hapsinore, deri sa ana e majtë karakterizohet me përpunimin verbal, në sekuenca dhe analitike të informacioneve. Ashtu që te ndonjëri mund të paraqitet me dominante ana e majtë, gjegjësisht hemisfera e djathtë dhe si pasojë paraqiten medime të preferuara të punës dhe mënyra të ndryshme të punës në grupe. Psikologët tjerë i klasifikojnë stilet e të mësuarit si reflektiv, përkundër impulsiv. Vëretja e këtij dallimi na orienton në nevojën për pranimin e qendrimit relaksues në lidhje me dinamikën e përfundimit të detyrave. Për këtë arsye, për disa nxënës, do të kishte qenë më mirë detyrat të ndahen në pjesë më të vogla të cilat më lehtë do t'i zgjedhin. Teoria e Gardnerit për më tepër lloje të inteligjencës mund të shfrytëzohet nga mësuesit. Kjo teori e ridifinon kuptimin për inteligjencën si aftësi për krijimin e produkteve ose si aftësi për zgjedhjen e problemeve që çmohen në një ose më tepër kultura. Pranimi i ekzistimit të më tepër inteligjencave nënkuptojmë edhe shfrytëzimin e më tepër medimeve dhe metodave. Mësuesi duhet të shfrytëzojë dallimet individuale, duke shfrytëzuar strukturën e grupimit, ashtu që të punojnë në detyrë të njëjtë. Nxënësve duhet t'u lejojë vetë të zgjedhin aktivitetet ku do të angazhohen, dhe të lejojë, nëse kanë ndjenja se puna nuk u shkonë për dore, të transferohen në aktivitete tjera, pa etiketime për nxënësit se janë “inteligjentë”, “të pa aftë për të mësuar”, “rizikë”, etj.

Mësimi interaktiv nëpërmjet parashtrimit të pyetjeve.

Taksonomia e Blumit


Parashtrimi i pyetjeve është mjet i fuqishëm për iniciimin ose për dekurajimin e zhvillimit të stilit kognitiv kreativ dhe kritik të nxënësve dhe mësuesve.

Nga aspekti i mësuesit, parashtrimi i pyetjeve divergjente është i rëndësishëm për procesin e krijimit të paraditurave të nxënësve, por edhe për vlerësimin e arritjeve në orë, si dhe në procesin e vlerësimit të arritjeve globale. Nga aspekti i nxënësve parashtrimi i pyetjeve transformohet në lloje të aftësisë për marjen e informacioneve nga mësuesi gjatë mësimin, ashtu edhe prej nxënësve tjerë, nëse procesi i mësimin zhvillohet sipas metodave më bashkëkohore. Edhe për mësuesit edhe për nxënësit me rëndësi është që të dinë të parashtrorjnjë pyetje të ndryshme kreative.



Pyetjet që parashtrihen në shkolla, kryesisht, janë të orientuara kah dituria faktografike, që në kushte sasisë së madhe të informacioneve është vetëm ngarkim për nxënësit të cilët janë të detyruar të mbajnë mend mijra fakte. Për nxënësit njohja e fakteve nuk ka ndonjë rëndësi të madhe, nëse ato nuk analizohen, sintetizohen ose rikonstruktohen në forma që do të jenë të zbatueshme. Për ata me rëndësi është të vendosin lidhje në mes diturive të reja me të vjetërat dhe të inicojnë të lidhin përmbajtjet e tyre me eksperiencën personale.

Ekzistojn kategori të ndryshme të llojeve të pyetjeve. Njëra prej më të njohurave është taksonomia e Blum-Sandersit për pyetjet. Taksonominë e ka krijuar Benxhamin Blumi, por Sandersi e bën revizionin e saj dhe bën renditjen hijerarike të pyetjeve, sipas procesit mendor që është i kyçur. Në këtë kategorizim sipas renditjes hijerarike, në nivelin më të ulët janë pyetjet në nivel të memorimit (të mbajturit mend), pastaj niveli i përkthimit, niveli i komentimit, niveli i zbatimit, niveli i analizës, i sintezës dhe niveli i evaluimit si nivel më i lartë. Secili nivel është më i rëndë më lartë në krahasim me nivelin paraprak, edhe pse shpesh është shumë rëndë pyetjet të definoen saktësisht cilit nivel i takojnë, sepse nivelet janë afër njëri tjetrit.



Niveli I - Pyetjet në nivel të memorimit: Këta pyetje kërkojnë përgjigje që do të gjendet në informacionet faktografike. Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë vetëm fakte të cilët janë theksuar ose të shkruajtur dhe nxënësit duhet t'i kujtojnë ose më thjeshtë t'i gjenë në tekst ose në ndonjë burim tjetër. Për këtë shkakë ky nivel quhet dhe nivel bukfal dhe paraqet kujtimin e informacioneve që më parë janë mësuar. Këto pyetje kanë vetëm një përgjigje të saktë dhe këto janë më të vështira për nxënësit, edhe pse nuk angazhojnë proces mendor më të komplikuar. Përgjigjet në këto pyetje duhet patjetër të mësohen përmendsh (të memorohen). Për shembull: Cili është kryeqiteti i Republikës së Maqedonisë? Përgjigje e saktë dhe e vetme është Shkupi.



Niveli II - pyetjet në nivel të kuptimit me dy nënnivele: pyetjet në nivel të përkthimit dhe pyetjet në nivel të komentimit

Pyetjet në nivel të përkthimit: këto pyetje kërkojnë transformim të informacionit të fituar ose ristrukturimin në senzacion vizuel dhe auditiv. Kjo donë të thotë se prej nxënësve kërkohetë ritregojnë ose të japin përshkrim të një ngjarje., skenë ose ndodhi, duke krijuar fotografi vizuale ose duke shtuar elemnete audio në informacionet që i marim. Prej nxënësve kërkohet të përgjigjen çfarë kanë ‘parë’ ose çfarë kanë ‘dëgjuar’. Gjatë kësaj duhet të krijon përvojë të shqisave të cilën e bartin te të tjerët. Në këto pyetje nuk ka një përgjigje të saktë. Sejcili nxënës përcjellë përjetimet e tij. Për shembull: Çfarë dëgjuat, cila është fotografia e parë për ju deri sa e lexuat tekstin?

Pyetje në nivel të komentimit: Më këtë lloj të pyetjeve fillon niveli më i lartë i të menduarit, duke pasur parasysh se këto pyetje prej nxënësve kërkojnë të zbulojnë (komentojnë) lidhjet në mes koncepteve të veçanta , ideve, fakteve, definicioneve dhe të ndërtojnë kontekste të ndryshme. Për shembull: Çfarë mendon, pse ngjarja ndodhi pikërisht në atë kohë?

Niveli III - pyetjet e zbatimit: Pyetjet për këtë lloj e orientojnë nxënësin të kuptoj zbatimin e ideve të caktuara, rregullave dhe teorive në zgjedhjen e problemit specifik në nivel të transformimit në jetën e përditshme. Për shembull: Shfrytëzoi dituritë e tua themelore dhe sqaro si krijohet ngjyra portokalli!

Niveli IV - pyetjet e analizës: Pyetjet kërkojnë analizën e ndonjë ngjarje, ndarjen në pjesë dhe kuptimi i relacioneve në mes tyre. Kërkohet përgjegje për ndonjë ngjarje a është e sqaruar përpikërisht ose përgjigjet tjera japin sqarim më të mirë. Për shembull: Në cilën mënyrë përfundimi i përgjigjet ngjarjeve në tregim? Cilët janë motivet e personazhit kryesor në vepër?

Niveli V - pyetjet e sintezës: Pyetjet e këtij niveli inicojnë zgjedhjen e problemeve në mënyrë origjinale dhe kreative. Konceptet ekzistuese, principet dhe idet shfrytëzohen për dizajnimin e diçka të re, për arritjen deri te përgjigjja origjinale. Pjesët e veçanta vendosen në kontekst të ri dhe krijojnë vepër origjinale të re. Për shembull: Si mundet në mënyrë tjetër të zgjidhet detyra? Si do t’a kishte mbaruar ti romanin?

Niveli VI - pyetjet e evaluimit: Me këto pyetje prej nxënësve kërkohet të sjellin gjykim, i cili më së shpeshti bazohet në kriteriume specifike, më pak në mendimin vetanak. Nxënësi jep gjykimin e vetë a është diçka e mirë apo jo, e drejtë apo e zhdrejtë. Për t’a arritur këtë, nxënësi duhet të kupton atë që e mëson dhe të integron në sistemin e besimit të tij, në këtë mënyrë sistemi mësimor bëhet personal. Për shembull: Në çfarë mënyre sjellja e njërit ka ndikuar te të tjerët? Në bazë të diturive tua nga gramatika, çfarë mund të thuash për paragrafin e dytë?

(adaptuar prej Petkovski K. dhe të tjerë (2005) “Aktivitetet proektuese”)



Puntoria për parashtrimin e pyetjeve - taksonomia e Blumit

Qëllimet:

- Njoftimi me nivelet e pyetjeve në taksonomin e Blumit dhe zbatimi i tyre në procesin mësimor/proektet e nxënësve; dhe
- Zbatimi i taksonomisë së Blumit, ushtrime për parashtrimin e pyetjeve.

Materiale:

- Krijimi i orës demokratike (Fletë për punë);
- Kubi (Fletë për punë);
- Anë të katruçit (kartonit) për formimin e kubitë
- Ngjitëse, flomasterë, lapsa, stilograf; dhe
- Niveli i pyetjeve (Fletë për punë)

Aktivitetet:

1. **Leximi i tekstit “Krijimi i klasës demokratike”**
2. **Përpunimi i tekstit me teknikën KUBI:** Sejcili prej nxënësve mer kopje të tekstit “Krijimi i klasës demokratike”. Pasi do t’a lexojnë tekstin, nxënësit ndahen në 6 grupe dhe sejcila grup përgjegjet në një pyetje të shënuar në anën e kubit.
3. **Formulimi i pyetjeve për tekstin:** Pas prezantimit të shkurtë për taksonominë e Blumit (në 6 grupet ekzistuese, sipas niveleve) kërkohet ndihmë në paraqitjen tabelare të nivelit të pyetjeve të formulojnë sa më shumë pyetje për tekstin.





Qasja integruese. Proektet e nxënësve

Fjala proekt definohet si plan, propozim ose skemë, gjegjësisht formulimi i planit për implementimin e aktiviteteve të caktuara. Për hyrjen e proekteve në arsim më tepër merita ka John Dewey.

Mësimi nëpërmjet proekteve është element i rëndësishëm në realizimin e procesit mësimor, për arsye se mundëson arritjen e diturive të ndryshme dhe shkathtësive nëpërmjet shfrytëzimit të resurseve të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të mbledhjes, klasifikimi dhe prezantimi i informacioneve, gjegjësisht integrimi i diturive dhe shkathtësive nga më tepër lëmi, lëndë. Nëpërmjet proekteve mundësohet që nxënësit pavarësisht (duke punuar në grupe dhe ekipe) të arrinë deri te më tepër informacione për temën e dhënë (në mënyrë kreative), gjatë kësaj ata janë personi qendror në procesin e mësimin. Dituritë e arritura në këtë mënyrë më gjatë mbahen mend.

Në këtë mënyrë të mësimin bëhen ndryshime në raport me mësimin tradicional. Nxënësi bëhet person qendror në procesin e mësimin, vetë ka përgjegjësi për përparimin e vetë, zhvillimin e shkathtësive për vendim-marje dhe mendim kritik, të marë iniciativë dhe t'a zhvillon kreativitetin e tij dhe të bëhet kompetent për akcion. Mësuesi e ndryshon rolin dominant të tij, e menaxhon dhe koordinon punën, e përcjellë dhe evaluon përparimin, ndihmon dhe paraqet burim të rëndësishëm të resurseve.

Kyçja në proekte për nxënësit çdo herë është eksperiencë e re. Eksperiancat nga proektet tjera plotësohen nga njëra situat në tjetrën, duke e zmadhuar vetëbesimin dhe kreativitetin e nxënësve. Njëkohësisht kjo don të thotë që nxënësit që nuk kan patur mundësi të marin pjesë në vendim-marje, planifikojn ose realizojnë idet e veta gjatë shkollimit të tyre do t'a kenë rëndë te gjenden në këtë rol.

Proektite mund të jenë pjesë e mësimin të përmbajtjeve mësimore, por gjithashtu, mund të paraqesin mënyrë për përpunimin dhe marjes së akcioneve për temat të cilat janë me rëndësi të madhe për shëndetin, ambientit jetësor, shoqërinë, pastaj për tema të ndjeshme siç janë, për shembull: sjelljet të rezikshme, dhuna, dhe në përgjithësi , temat të cilat kërkojnë vendim-marje për jetën tonë, stili jetësor, dhe të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve në shoqëri. Rëndësi të veçantë është se këto tema të trajtohen në shkollë dhe të kyçen në mënyrë aktive nxënësit të cilët duhet të udhhiqen në proces dhe t'u mundësohet pjesëmarje autentike dhe zhvillim të kompetencave për aksione.



Korniza metodologjike për udhëheqjen e projekteve për nxënësit

(S)IVAP¹ modeli është qasje që rrjedhë nga përvoja e mësuesve gjatë udhëheqjes së projekteve. Ky model shërben si kornizë për udhëheqjen e projekteve të nxënësve, inicon pjesëmarrjen autentike të nxënësve, krijon hapsirë për komunikim të lirë dhe kreativ, dizajnon dhe zhvillon principe demokratike të dialogut dhe bashkëpunimit dhe në këtë mënyrë mundëson realizimin e ndryshimeve në bashkësi.

Mund të aplikohet në procesin mësimor për mësimin e tërësive mësimore dhe temave dhe në aktivitetet e lira për iniciimin e ndryshimeve në shkollë. Ky model inicon dialogun e përbashkët, pjesëmarrjen autentike dhe aktive të nxënësve dhe zhvillon kompetencat për akcione.

Selektimi

Selektimi i temës paraqet fillimin e dialogut të përbashkët në grup. Nënkupton pjesëmarrje të numërit më të madhë të pjesëmarrësve sa është i mundëshëm dhe është shumë me rëndësi motivimi i nxënësve dhe për pjesëmarrje “pronësisë” për projektin. Mësuesi ofron lëmi-njësi metodike ose lëmi prej jetës së përditëshme, shëndetësis, shkollës... Pastaj, nxënësit më së shpeshti në grupe, propozojnë tema nga lëmia. Rrjedhë zgjedhja e një teme gjatë së cilës aplikohen procedurat për sjellje të vendimit (votimi, konsenzusi). Me rëndësi është sejcili të ketë hapsirë për pjesëmarrje, të shpreh mendimin, iden dhe propozimin e tij. Shpesh për këtë qëllim bëhet lista e të gjithë propozimeve të nxënësve, kurse pastaj propozimet - diskutohen deri sa nuk arrihet konsenzusi (kjo procedurë zgjatë më tepër) ose votohet për secilin propozim dhe zgjedhet propozimi me më tepër vota. Nxënësit, gjithashtu mund të marrin pjesë në dialog dhe për cilën procedurë të zgjedhjes do të zabatojnë.

Investigimi (hulumtimi)

Investigimi fillon me diskutimin dhe shkëmbimin e diturive, informacioneve, qëndrimeve, dilemave, pyetjeve.... të cilat i kanë nxënësit në lidhje me temën. Pyetja themelore që diskutohet është; “Pse kjo temë/problem është me rëndësi për ne?”, gjithashtu është me rëndësi pyetja: Çfarë di për temën? Cilët janë qëndrimet e mia...?

Është e nevojshme të lihet kohë aq sa duhet dhe t’u lejojë nxënësve të mendojnë (mësuesi të mos e jep “përgjigjen e vërtet”, por t’u lejon nxënësve ta formulojnë, t’a krijojnë, të vlerësojnë). Në procesin e mësimin, zbulimi, ndërlidhja e ideve, shpesh paraqiten ide cilat duket se janë të kqija, pa lidhje, kontradiktore, hutuese.... mësuesi duhet të qartësojë se kjo është rrjedhje normale dhe pjesë natyrore e procesit të menduarit dhe kjo nuk duhet të tallet.

¹ Qasja origjinale IVAP (Investigim, Vizion, Akcion, Ndryshim) është krijuar në Danimark në kuadër të projektit Rrjeti evropian i shkollave që e avansojnë shëndetin nga Prof. Dr. Bajrne Brun Jensen dhe përvojat e këtij projekti në Danimark. Selekcioni është fazë e plotësuar nga përvojat e projektit në Rrjetin e shkollave në Maqedonisë që e avansojnë shëndetin.



Roli i mësuesit është që të orientoj dhe të inicoj mendime dhe me kujdes të dëgjon idet e nxënësve. Ai inicon, e zmadhon interesin, mbledh, provokon me pyetje nxënësit të mendojnë për atë që e dinë, me qëllim të krijohet baza për zhvillim dhe rindërtim të diturisë ekzistuese.

Nxënësi nuk qendron pasiv, por nëpërmjet pyetjeve provokative (kontradiktore) është i provokuar të mëson diçka të re.

Pregaditjet për investigim vazhdojnë me planin për investigim:

Çfarë? Cilat aspekte të temës/problemit do të jenë lëndë për investigim të mëtutjeshëm. (Këto janë pyetjet që duhet të parashtrihen në lidhje me rëndësinë e temës: Sila është rëndësia e temës për të tjerët? Çfarë mendojnë/dinë/dëshirojnë/nuk dëshirojnë të tjerët? Si ka qenë në të kaluarën? Cilat janë shkaqet për gjendjen e momentale? Si është në vende tjera? Çfarë, si mund të ndryshohet?...);

Ku do të investigojmë? Cilat resurse duhet të shfrytëzohen, cilat njerëz, institucione, teknologji.....

Si? Cilat instrumente do t'i shfrytëzojmë? (Intervista, pyetsor, anketa, kërkim në Internet, gazeta, gazeta javore, arkive, biblioteka, mënyra kreative dhe kualitative të investigimit dhe dokumentimit, për shembull: monitorim dhe dokumentim të monitorimit me fotografi, vizatime në vend të pyetsorve, analiza e krijimeve (këngë, filma, tregime)... përmbledhë dhe pregaditjen e instrumenteve (pyetje, përkthime, instrukcione, printim);

Kur? Planifikimi i kohëzgjatjes së aktiviteteve; dhe

Kush? Ndarja e përgjegjësive dhe detyrave.

Pjesë e planifikimit është mendimi për **problemet** dhe **barierat** e mundshme dhe përpilimi i strategjisë për tejkalimin e tyre.

Roli i rëndësishëm i mësuesve në këtë fazë është që tu japin mbështetje dhe t'ju ndihmojnë nxënësve në arritjen deri te informacionet dhe diturive relevante. E patjetërsueshme është që mësuesët gjithmonë të jenë një hap para nxënësve dhe gjithëmonë të kenë tërësinë dhe procesin para veti. Në këtë fazë kjo nënkupton pjesëmarrjen aktive të tyre në procesin e planifikimit të investigimit dhe investigimin në praktikë. Gjegjësisht, **propozon dhe udhëzon** (për shembull: cilat resurse mund të shfrytëzohen), **ndihmon** (për shembull: formulimi i pyetjeve për intervista, anketa, pyetësor), **inicon** (për shembull; për gjetjen e mënyrës kreative për tejkalimin e barrierave) në pregaditjen e investigimit, por gjithashtu edhe **investigon** për temën / problemin dhe informatat i këmben me nxënësit, pastaj i **mbështet, lobon dhe organizon** (për shembull: i paraqet, i lajmëron te drejtori ose në institucione tjera të bashkësisë lokale) për kohën e investigimit në teren. Kjo nuk duhet të kuptohet se mësuesi duhet të bën të gjithë hapat, kurse nxënësit vetëm të paraqiten në vendin e caktuar, por më tepër të jetë i pranishëm rrethë pregaditjes dhe në raste të caktuara të mbështet dhe të ndihmon.



Investigimi në teren është pjesë shumë ekzcituese e procesit për fëmijët kur ata me të vërtet e ndijenë lirin, përgjegjësin dhe pronësin e proektit. Rregullimi i të dhënave nga investigimi është e domodoshme për zbulimin e vlerave personale gjatë procesit. Çfarë mësuam, dëgjuam, shiquam, provuam ...? Së pari fillohet me përpunimin e të dhënave të mbledhura në teren (numërimi i përgjigjeve nga pyetësi, analizimi i ngjajshmërive dhe dallimeve, kategorizimi i përgjigjeve, rregullimi i deklaratave gjatë intervistës, shiqimi dhe rregullimi i materialeve të dokumentuara, këmbimi i përvojave, përjetimeve, dituritë nga investigimi në teren dhe diskutimi për domethënien e tyre). Bëhen sumime për diturit e reja dhe në mënyrë aktive rikonstruktohen skemat për pranimin e koncepteve të reja, në fakt mësohet ajo që do të ngel më gjatë e mësuar. Nxënësit me fjalët e tyre duhet të rivedinojnë atë që e kanë kuptuar dhe në këtë mënyrë formojnë kontekst të rëndësishëm personal. Gjatë këmbimit, nxënësit vërejnë skema të ndryshme dhe zgjanojnë të vetën. Rezultati i përfituar nuk vlerësohet, kritikohet ose ndërrohet, por shfrytëzohet më tutje, si inicie i fazës së ardhshme ose temës. Kur nxënësit do të fillojnë lirshëm t'i tregojnë idet e tyre do të paraqitet një llojllojshmëri-gjatë së cilës duhet të braktisim besimin se ekziston vetëm një zgjedhje e saktë dhe të potencohet se janë më të rëndësishëm: mënyra, procedura, procesi i arritjes deri te zgjidhja, se vetë përgjigja/produkti/procesi. Shumë është me rëndësi të theksohet besimi në aftësinë e secilit nxënës të gjykojë në mënyrë kritike (kur mësuesi shprehë respekt ndaj ideve, mendimit të nxënësve, atëherë edhe ata fillojnë të tregojnë respekt më të madh ndaj mendimit të vet), si dhe të diskutohet për vetë procesin e mësimit, nxënësit t'a kuptojnë përmbajtjen, por edhe vet procesin e mësimit.

Para **prezentimit të rezultateve** nga faza e ivestigimit (hulumtimit) duhet të bëhet përgatitja e materialit të përfituar i cili duhet t'i tregojë rezultatet, por edhe të dërgon mesazhin e caktuar dhe të hap pyetje të reja. Gjithashtu, duhet të organizohet tërë prezantimi: vendi, zgjedhja, rregullimi...), koha (zgjedhja e datës, programi detal), pjesëmarrësit (ndarja e detyrave, përgjegjësive, rolet), misafirët (thirjet, kontaktet...). Gjatë prezantimit të materialeve mund të shfrytëzohet mënyra të ndryshme kreative dhe kualitative të paraqitjes nëpërmjet vizatimeve, fotografive, grafikoneve, vizatimit të hartave, modelimi, shfrytëzimi i simboleve, muzika, libri, dramatizimi....

Çfarë mësuam, arritëm të kuptojmë, shiquam, provuam, dëgjuam...? Rregullimi i të dhënave nga investigimi është e patjetërsueshme për vendosjen e qëllimit dhe caktimit të sfidës për zbulimin e diturive personale në procesin e udhëtimit të përbashkët dhe dialogut. Pyetjet e fundit janë: Çfarë dëshirojmë të përmirësojmë? Cili është qëllimi jonë?

Në fakt këto pyetje janë hyrje në fazën e ardhshme.



Vizioni

Si mund të jetë në të ardhmen? Çfarë duam të ndodhë në të ardhmen?

Fëmijët paramendojnë realizimin, situatën ideale në raport me temën/problemin, e formojnë vizionin e tyre, japin forma, ngjyra, zë ose muzikë, e shëndrojnë në lëvizje, në lojë... Kjo fazë në të cilën më tepër potencohet dhe vjen në shprehje nevoja për liri dhe shprehje dhe krijim kreativë.

Mësuesit janë ata të cilët e krijojnë hapsirën dhe kushtet për fëmijët që ata të ndjehen të lirë dhe të gjurmojnë për vizionin e tyre, pa korigjime dhe ndërhyrje.

Akcioni

Si t'a arrijë cakun? Si të bëjmë ndryshimin e nevojshëm?

Këto pyetje në fillim të fazës në të cilën duhet të ndërmerren hapa konkret për realizimin e ndryshimeve. Ndryshimi gjegjësisht, akcioni duhet në një farë mënyre të kontribuojnë për përpjesëtimin e situatës e cila është e lidhur me temën e zgjedhur, edhe pse ndonjëherë në pikëpamje tematike duken të ndryshme (për shembull: tema e parë është dhuna, kurse në akcion përqipemi të vendosim kohë posaçërisht të organizuar për lojë, që sipas nxënësve do ta zvogëlonte dhunën dhe do t'a transformoj energjinë negative, ose tema e parë për hapjen e kafiterisë në shkollë, kurse akcioni ka të bëjë me përmirësimin e mardhanieve multi-etnike dhe zvogëlimi i mungesave të cilat gjatë investigimit janë paraqitur si barrierë kryesore për hapjen e kafiterisë). Akcioni mund të nënkuptojë rregullimin e klasës, oborin, organizimin e garave, formulimi i informatorit, pamfletit, posterit ose gazetës muri, organizimi i trajnimeve për moshatarët dhe produkte tjera të ndryshme dhe aktivitete të cilët dalin prej temës dhe ideve të fëmijëve.....

Akcionet janë pjesa më e rëndësishme e realizimit të projekteve të nxënësve. Në akcione shpesh vjen deri në ndeshje me kufizimet në ambient, paraqitet numër i madh i barrierave dhe kjo në masë të madhe ndikon në motivacionin e nxënësve dhe ndjenjat dhe përjetimet e tyre. Më me rëndësi është që nxënësit t'i mësojnë rrugët dhe procedurat me të cilat mund të sjellin ndryshime, pastaj dërgimi i meazazheve ose ngritja e pyetjeve të caktuara në nivel të problemit. Hapja e disa problemeve, vet ajo që është dëgjuar zëri i tyre mund të jetë akcion i nevojshëm dhe në këtë mënyrë është arritur ndryshimi prej situatës paraprake, para se të fillojë projekti.

Që të jetë akcioni i suksesshëm duhet të jetë mirë i instaluar. Përgaditet plan për akcion, i cili do të përmban hapat e njëjtë sikurse plani për investigim:

Çfarë të bëjmë? Definimi i hapave të aktiviteteve (për shembull: do të organizojmë tribunë për diskutim, dotë bëjmë pamflet për informim, gazetë të shkollës, film...)

Si? Bëjmë marrëveshje për strategjit për realizimin e aktiviteteve (Për shembull: për përgaditjen e tribunës: përgaditja e pyetjeve për diskutim, siguri i hapsirës dhe terminit, planifikimi i pjesëmarrësve, informim, zgjedhja e liderve . . .)



Kush? Shpërndarja e detyrara sipas marëveshjes

Kur? Përcaktimi i kornizës kohore në të cilën parashihet realizimi i aktiviteteve.

Cilat janë **problemet dhe barrierat** e mundëshme? Si do ti tekalojmë?

Mësuesit duhet t'u **japin kurajo dhe t'ju ndihmojn** nxënësve që të mos japin dorëheqje dhe të mundohen me sukses t'a realizojn akcionin. Me rëndësi është roli i mësuesit në zgjedhjen e temave për akcion, kur duhet të inicojn **gjetje të zgjidhjes** për probleme të caktuara, por edhe të inicojn mendim kritik për realizimin e ideve dhe propozimeve. Kjo asnjëherë nuk duhet të kuptohet si diskualifikim të ideve të caktuara vetëm për shkak se në fillim duken si jorealistike, të pamundëshme. Me rëndësi është mësuesi t'ju ndihmoj të **sqarohen hapat e realizimit** të ndonjë qëllimi/ideali, mësuesi duhet gjithëmon të **besoj dhe t'ju jap kurajo** nxënësve se realizimi i qëllimeve është i mundshëm, me organizim të mirë, planifikim, përkushtim të nevojshëm, kohë. Ndonjëherë qëllimet arrihen me disa akcione dhe më tepër proekte. Shpesh nxënësit nuk besojn në mundësin se ata mund të bëjnë ndonjë ndryshim dhe është e nevojshme **motivim plotësues dhe besim në potencialin fëmijror** për të tejkaluar këtë fazë. Më e rëndësishme është të bëhen të gjithë përpjeket dhe të shfrytëzohe të gjithë mënyrat dhe procedurat për të arritur ndryshimin e dëshiruar. Në fund, rezultati i akcionit është i pasigurt dhe mësuesi duhet të flasë me nxënësit për rezultate të ndryshme dhe rëndësin e tyre. Shumë është me rëndësi të potencohet se ajo që ndodhe me procesin, ajo që fëmijët e kanë mësuar është me rëndësi dhe do t'ju shërbej në situata tjera jetësore, se rezultati nuk është i lidhur kryesisht me punën e tyre dhe se ka sende ndaj të cilave nxënësit nuk mund të ndikojn me një akcion ose me një projekt, por se ndryshimet gjithmon janë të mundëshme.

Informimi i bashkësisë së shkollës dhe/ose lokale mundëson shpërndarjen e informacioneve dhe transparencën e procesit, mundësia për kyçjen e anëtarve të tjerë dhe sigurimi i mbështetjes më të gjërë. Ndonjëherë informimi paraqet pjesë të akcionit ose qëllim të akcionit në projekt, posaçërisht për tema që janë me rëndësi, paraqiten dhe përpunohen për herë të parë nëpërmjet proekteve të nxënësve, dhe ne megjdis ku informacionet pak qarkullojnë dhe nuk arrijn deri te anëtarët e bashkësisë. Informimi i bashkësisë më të gjërë duhet të jetë pjesë e të gjitha fazave të projektit. Informimi mund të bëhet me lajmërimi të thjeshta, pamfleta, lamërimi, informacione në medime, thirrje për pjesëmarrje në ndonjë ngjarje, posterat, gazetatat e murit, mbledhjet, prezantimet...

Ndryshimi

Ndryshimi nuk ndodhë vetëm në fund, por është i pandashëm gjatë gjithë procesit të projektit. Ndryshimet ndodhin te të gjithë pjesëmarrësit, si dhe në bashkësi.

Ndryshimet paraqesin plotësim të përvojës nga akcionet dhe bazë për kompetenca për veprimet e ardhshme.



Punëtori për udhëheqjen e proekteve të nxënësve

Qëllimet

- Aftësimin e mësuesve për udhëheqjen e proekteve të nxënësve; dhe
- Njohftimi me metodat individuale dhe grupore, përcjellja dhe dokumentim të procesit.

Materiale:

- Fletë të madhe të letrës, markerë, flomasterë, stilograf, plastelin;
- Muzikë, materiale të ndryshme kreative
- A4 dhe A3 letër;
- Plan individual për hulumtim (Fletë për punë);
- Plan grupor për hulumtim (Fletë për punë); dhe
- Raport periodik (Fletë për punë)

Aktivitete:

1. Selektimi: Pjesëmarësit ndahen në grupe nga 4 deri 5 anëtarësh. Grupet bisedojnë çfarë dëshirojnë të ndryshojnë në shkollë. Pastaj i prezantojnë idet dhe i shënojnë në fletë të madhe ose tabelë. Atëherë kur të gjithë i kanë prezantuar idet e tyre zgjedhet tema me votim ose konsensus.

2. Investigimi: Investigimi bëhet në grupe nga jo më tepër se 4 anëtarë. Pjesëmarësit përgatisin plan për investigim. Pastaj simulojnë investigim në teren.

3. Prezantimi: Grupet përgatisin prezantim të rezultateve nga investigimi.

4. Vizioni: Të gjithë pjesëmarësit marrin pjesë në formimin e vizionit. Shfrytëzojnë modalitete më të ndryshme të shprehjes: vallzim, dramatizim, ngjyra, muzikë, plastelin.....

5. Veprimi: Grupi nëpërmjet diskutimit zgjedh çfarë ndryshimi do të realizojë. Pasi të zgjedh temën për veprim, përsëri grupi diskuton për organizimin e aspekteve të ndryshme të veprimit, pastaj bëhet plani për veprim.

6. Ndryshimi: Diskutimi për procesin dhe ndryshimet.



Punimi i planit grupor dhe individual për përcjelljen proekteve të nxënësve-portfolio

Portfolia e nxënësit paraqet dosie të projektit në të cilën shënohen të gjitha fazat dhe aktivitetet. Në portfolio perceptohet edhe verifikimi i saj, edhe kontinuiteti i punës dhe rezultatet e arritura. Roli i mësuesit është përcjellja e nxënësit dhe portfolios së tij. Portfolio është material i selektuar dhe duhet të përmbaj: përmbajtjen, kornizën kohore, raportet periodike për punë, proces-verbalet nga konsultimet e mbajtura të ekipit, realizimi i aktiviteteve në bazë të fazave, plan grupor për investigim, planet personale të anëtarve të ekipit, shënimet e mësuesit për përcjelljen e planeve individuale, shënimet për barrierat që janë paraqitur, resurset e shfrytëzuara, punimet e nxënësve, përpunimi i të dhënave, konkluzionet nga investigimi, prezantimi i pregaditur për rezultatet. Portfolion mund t'a udhëheq mësuesi për nxënësit, por gjithashtu nxënësit për vete, veçmas dhe për gjithë grupin.

Kjo mënyrë e përcjelljes dhe vlerësimi/evaluimi i angazhimit të nxënësve mundëson vlerësimin e kontributeve grupore dhe individuale në rrjedhjen e gjithë procesit. Gjatë dokumentimit permanent nxënësi dhe mësuesi kanë mundësi të mësojnë gjatë procesit, të mësojnë nga lëshimet dhe të jenë gjithëmon të motivuar për ti përmisuar të arriturat, të vendosin qëllime më të larta dhe standarde. Edhe një benifit i përcjelljes të pandërprerë të nxënësve paraqet mundësi nxënësit të mësojnë vetën e tyre, gjegjësisht punën e tyre t'a vlerësojnë, në mënyrë konstruktive dhe kritike të mendojnë për angazhimin e tyre dhe metodat dhe në këtë mënyrë të ketë pasqyrë reale për të arriturat e veta.

Gjithashtu portfolio mundëson:

- Standardizimin (unifikim) e vlerësimit të kontributit të secilit anëtar të ekipit si dhe tërësis;
- Zhvillimi e aftësive për komunikim social-fotografia për zhvillimin e shkathtësive kooperative të nxënësve, siç janë: toleranca, bashkëpunimi, respektimi i mendimeve të tjerëve;
- Avansimi i mardhënieve mësues-nxënë;
- Fotografinë e aktiviteteve të çdo individi, të ekipit, të udhëheqësit të ekipit dhe të mësuesit. Prej tij mund të shihet:
- Thellësia e investigimit-nëpërmjet shfrytëzimit të gjithë resurseve në disponim, materialet profesionale dhe nëpërmjet bashkëpunimit me të tjerët;
- Gjëresia - lista e diturive dhe shkathtësive; dhe
- Përparimi i diturive



Moduli 2

Përparimi i shëndetit në shkollë

Çfarë është shëndeti? Çfarë është person i shëndetshëm? Çfarë është një komunitet i shëndetshëm? Me siguri, nëse i parashtrojm këto pyetje dhe orvatemi të arrijm marëveshje do t'a kuptojm se shëndeti nuk është thjeshtë mungesa e smundjes, por mund të mos ndjehemi të shëndetshëm, edhe pse nuk na dhemb koka dhe se të jeshë i shëndetshëm është më e komplikuar, e ashtuquajtur mirëqenie e përgjithshme. Kjo do të thotë dhe mbulon shumë aspekte të ndryshme të shëndetit: fizike, mendore, emocionale, sociale dhe shpirtërore. Kjo mënyrë e interpretimit të shëndetësisë quhet **qasje holistike** sipas së cilës shëndeti është "**gjendje e plotë fizike, mirëqenie psikike dhe sociale, kurse jo mungesa e sëmundjes**".

Të jeshë i shëndetshëm në kontekstin shkollorë do të thotë:

- Nxënësi të kujdeset për vetën dhe për të tjerët;
- Nxënësi në mënyrë të pavarur të sjell vendime dhe të ndërmarin veprime për kushte të shëndetëshme jetësore; dhe
- Nxënësi dhe anëtarët tjerë të komunitetit shkollor të kyçen bashkërisht në përparimin e shëndetit.

Nxënësit në shkollë kalojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre. Shkolla është vendi ku nxënësit vetëm nuk mësojnë, por edhe socializohen dhe ndërtojnë stilin e vet jetësor. A do të jetë zgjedhja dhe vendimi i tyre për mënyrën e shëndetshme të sjelljes nuk varet vetëm prej asaj se në shkollë do t'i arrijnë diturit e nevojshme se çka është e shëndetshme, dhe çka nuk është. Zgjidhja e tyre për stil jetësor të shëndetshëm do të jetë më i fortë nëse nxënësve u lejohet ajo, para së gjithash, të sjellin vendimi i pavarur dhe personal i tyre.

Duke vepruar në nivel të komunitetit shkollor, arsimit efektiv nëpërmjet konceptit global për shëndetin si tërësi e shëndetit fizik, psikik dhe social, nëpërmjet besimeve, qëndrimit dhe sjelljes të personit (si pjesë e komunitetit) dhe mundësit e mejdisit, nënkupton edhe kyçjen aktive të sejcilit person në krijimin e saj. Me fjalë tjera, kjo do të thotë involvimin komplet personal të personit (nxënësit) në dizajnimin e stilit të shëndetshëm jetësor, me vetëdije për nevojat e veta, për zakonet, karakteristikat kulturore dhe për mundësit (vetanake dhe ata të komunitetit) të marrin pjesë në proces.

Ndërtimi i stilit të shëndetshëm jetësor në kontekst të konceptit të ri për shëndet dhe strategjit e reja për përparimin e tij parasheh pjesëmarrje aktive të personit (nxënësit) në më tepër procese: prej procesit të informimit, diskutimit për rëndësit, rishikimi dhe zgjidhja e alternativave, vendosja për strategjit, veprimi, tejkalimi i pengesave të mundëshme, etj.



Përpjekjet e hershme për të zgjidhur probleme të mëdha shëndetësore të sotme, siç jnaë: SIDA, narkomania, alkoolizmi, sjellje agresive në mesin e rinisë, etj. me trajtimin parcial të tyre nuk ka dhënë rezultatet e pritshme. Informimi i mirë për çështjet e shëndetit dhe për rreziqet që n'a kërcënohen, pa dyshim nuk mjafton tashmë si strategji efektive në përpjekjet për përparimin e tyre.

Vetëm me pjesëmarrjen aktive të çdo individi për të zmadhuar cilësinë e kujdesit për kualitetin e jetës së tyre, që udhëhiqet me kompetencë dhe jetohet shëndetshëm. Njëkohësisht, kjo mund të thotë edhe fillimin e ndërtimit të përgjegjësisë, jo vetëm ndaj vetës së tyre, ndaj shëndetit të tyre dhe mejdisin që e rrethon, por edhe më globalisht, të përgjegjësis për raportin e vet ndaj mejdisit (social dhe fizik) - në fillim në nivel të vendimeve vetanake, kurse pastaj në nivel global nëpërmjet incimit të veprimeve dhe zhvillimin e strategjive në komunitet më të gjërë. Jo vetëm në të tashmen por edhe në të ardhmen.

Studimi i rastit: Udhëheqja e projektit të nxënësve për zhvillin e zakoneve të shëndetshme “Të rinjtë dhe pirja e duhanit”.

Ekipi i projektit të nxënësve: Në projekt marin pjesë 32 nxënës prej klasës së shtatë nga shkolla fillore “A.S. Kikish” nga Tetova. Kanë punuar bashkërisht për 4 muaj në projekt, në vitin shkollor 2005/06, nën udhëheqjen e psikologes Snezhana Stojanovska.

Selektimi: Nxënësit e përfaqësuan shkollën dhe vendin e tyre nëpërmjet vizatimit, simbolit dhe hartës. Pastaj pasoi prezantimi i vizatimeve dhe punës në grupe të vogla: diskutimi për atë se çfarë do të ndryshonin në shkollë, çfarë mund të bëhet që të jetë më mirë. Pas diskutimit secili nxënës propozoi temën e tij për projekt në shkollë, pastaj nëpërmjet konsenzusit secili grup caktoi një temë. Nxënësit përsëri votuan se cila temë (nga grupet) do të jetë finale. Në këtë mënyrë tema **”Të rinjtë dhe pirja e duhanit”** fitoi më tepër vota. Në fund u parashtrua pyetja a janë të gjithë të knaqur me zgjedhjen e temës dhe nxënësit unanimisht u përgjigjën “po”.

Aktivitet përgaditore: Nxënësit morën pjesë në disa puntori përgaditori (komunikimi dhe dëgjimi aktiv, bashkëpunimi, stuhi idesh për fjalën cigare). Në këtë mënyrë u siguroa hapsirë e sigurtë për ndërtimin e kohezionit grupor dhe implementimin e diskutimeve në puntori, pjesëmarrja aktive e nxënësve në ndërtimin e qasjes dhe investigimit të problemit, si dhe definimin dhe përpunimin fillestar të temës.

Investigimi (hulumtimi): Faza investiguese filloi me diskutim, këmbimin dhe ndarjen e diturive, informacioneve, qendrimeve, dilemave, pyetjeve ...të cilat nxënësit i kishin në lidhje me temën. Pyetja themelore për diskutim ishte: “Pse kjo temë/problem është me rëndësi për ne?” Pasoi pëpunimi i planit për investigim (çfarë do të investigohet, ku, kur, si, kush, barrierat dhe tejkalimi i tyre).



Nxënësit sipas planit e fillojn investigimin në teren:

- Mbledh të dhëna në Internet;
- Interviston dhe anketon nxënës dhe mësues në shkollën e tij, si dhe shkollat tjera në Tetovë;
- Interviston doktor, pirës të duhanit, pirës të duhanit të mëparshëm dhe person të smurë nga kanceri i mushkërive të bardha;
- Analizuan të dhënat nga studimet ndërkombëtare të shëndetit të fëmijëve; dhe
- Analizuan regullativën për pirje të duhanit në vendin tonë dhe e krahasuan me vendet nënshkruese të marveshjes ndërkombëtare Konventa e OBSH për kontrollin e duhanit.

Pjesë nga rezultatet:

- Nxënësit e klasës së gjashtë ende nuk kanë provuar të pinë duhan;
- Te nxënësit e klasës së tetë 35% e meshkujve dhe 11% e femrave kanë provuar duhanin;
- Nxënësit të cilët kanë provuar duhanin në përqindje të madhe nuk vazhdojnë të pinë duhan çdo ditë; dhe
- Në bazë të vendimit të nxënësve të fillojn apo të mos fillojn të pinë duhan, ndikim më të madhë kanë prindërit.

Mjeku: Është vërtetuar se tymi i duhanit i cili është plot me materie helmuese e rezikon shëndetin e të rinjëve, i dëmton enët e gjakut, shkakton kollitje dhe ngulfatje, ndron ngjyrën e zërit dhe tenin e fytyrës, poashtu dëmton shqisat e të nuhaturit dhe shijes. Duhanëpirësit për kohë të gjatë janë jorezistent ndaj infeksioneve dhe mund të sëmuren nga kanceri i mushkërive të bardha. Shëndeti i një jo duhanëpirësit është shumë i rrezikuar nëse gjendet në prani të duhanpirësve. Hulumtimet vërtetuan se shtohet numri i joduhanpirësve të sëmur nga kanceri i mushkërive të bardha, ifarkti dhe bronhitisit, si rezultat nga ajo se kanë qendruar një kohë më të gjatë në të njëjtin ambient me duhanëpirës ose për ate se kanë jetuar me ata. Kur në shtëpi prindërit pinë duhan, ajo është një lloj sikur të pinë duhan e gjithë familja. Joduhanëpirësit të cilët qendrojnë në të njëjtin ambient me duhanëpirës sot quhen duhanëpirës pasiv me mënyrë të rrezikshme të jetesës.

Duhanëpirës: Për herë të parë ka filluar të pijë duhan në moshën 13-vjeçare, ndërsa ka vazhduar në moshë 23- vjeçare për t'i bërë shoqëri shoqës së saj. Ajo don të largohet nga duhani por ka nevojë për fuqi për ta bërë ate. “Nëse kishte mundur të kthej kohën prapa, asnjëherë nuk do të kishtë filluar të pijë duhan, është e vetëdijshme se cigaret negativisht ndikojnë në shëndetin e saj.

Joduhanëpirësi: Jam i vetëdijshëm për dëmin nga duhani në çdo pikëpamje: shëndetsor, financiar, shoqëror. Kur ndonjë shok ose shoqe pinë duhan unë mundohem t'i bind me informacione të ndryshme që i di, sepse me pirjen e duhanit jo vetëm se i bëjnë dëm vetes, por edhe të tjerëve që janë për rrethë.



Duhanëpirës i mëparshëm: “Me ndihmën e nënës sime pata sukses që të lë cigaret... Shumë jamë i gëzuar. Fillova të pi duhan shumë i ri, nga kurioziteti, por edhe nën ndikimin e shoqëris. Në fillim nuk kisha asnjë pengesë, por tash u paraqitën probleme shëndetsore me frymëmarjen: kollitje dhe probleme tjera me frymëmarjen dhe mushkërit e bardha. Tash ndihem shumë mirë dhe jam krenar me atë që e lash duhanin në kohë. Asnëherë nuk është vonë.”

I smurë nga kanceri: “Njerëzit që nuk pinë duhan asnjëherë most ë fillojn, nëse duan ardhmëri më të shëndetëshme për veti dhe për të tjerët. Ata, që pinë duhan duhet të bëjnë të gjitha që t’a lënë, për arsye se asnjëherë nuk është vonë...”

Të dhënat e përfituara nxënësit i përpunuan, i diskutuan dhe i nxorën propozimet si vijon:

- Ti je ai që vendos a do të pish duhan apo jo, sepse askush nuk mund të detyrojë nëse ti nuk do. Nëse do atëherë informohu dhe përsëri vendos vet!
- Në vend që të shpenzosh të holla për duhan, blej një çokollatë ose diçka tjetër që të pëlqen. Cigaret janë pa shije, pa vlerë dhe me shumë pasoja për shëndetin tënd.
- Nëse je në shoqëri të duhanpirësve, ndërsa ti nuk do të pish, mos u largo nga shoqëria, por mundohu t’a informosh shoqërin për atë që veç më e dinë.
- Çdo mësues duhet të dijë si t’u afrohet fëmijëve dhe me ndihmën e tyre t’i hulumtoj kushtet dhe pasojat nga pirja e duhanit, jo vetëm nëpërmjet ligjirave monotone por edhe nëpërmjet bashkëbisedave dhe fakte shkencore.
- Prindërit duhet të dijnë kur dhe si e kalon kohën fëmija i tyre dhe çka ndodh me të. Kontakti me fëmijën është gjëja kryesore për prindin. Ashtu prindi do të mund t’i besoj edhe kur nuk është me të. Atëherë edhe të hollat që i’a jep do të jenë të harxhuara për atë që janë kërkuar, e jo për duhan.

Vizioni: Nxënësit paramenduan situatë ideale në krahasim me temën, e formuan vizonin e tyre “Shkolla pa duhan”, dhe dhanë forma, ngjyrë, zë, muzikë e transformuan në lëvizje, lojë....

Veprimi: Në fillim nxënësit e përpunuan planin për akcion (çka, kur, si, ku, cili, barrierat dhe tejkalimi i tyre). Rezultatet e fituara nga hulumtimi, si dhe propozimet e tyre për ndryshime në rregullativën për pirjen e duhanit në shkollë, vendosën t’i paraqesin nëpërmjet informatorit-flaer dhe prezantimi para komunitetit më të gjërë lokal. Pason definimi i renditjes së temave në flaer, si dhe një numër i madh i provave dhe ushtrimeve për prezantim; paralelisht u zhvillua edhe procesi për informim të komunitetit lokal. Flaerat ishin të ndarë gjatë prezantimit të cilin e ndiqnin një numër i madh i prindërve, mësuesve dhe nxënësve. Më pas vijon informimi për proektin nëpër të gjitha klasat e shkollës dhe takimi me drejtorin për ndryshime në rregullativën e shkollës për pirjen e duhanit.



Shëndeti mental dhe emocional

Shëndeti mental mund të definohet si mirëqenie e cila mundëson individi të realizoj aftësi vetanake, të meret me situatat e përditëshme me stres, në mënyrë produktive dhe me sukses të punon dhe të jep kontributin e tij në komunitet. Shëndeti mental parashikon përjetim pozitiv dhe pajtimi me vetëveten, mardhënie të mira me të tjerët dhe me sukses të meret me sfidat jetësore.

Përballimi dhe kontakti me ndjenjat autentike, emocionet, përjetimet dhe situatat me pjesë të pandarë nga zhvillimi i jon mental dhe emocional. Shumë më pak është e shëndetëshme ignorimi dhe shtypja e ndjenjave negative të cilat më vonë çdo herë kthehen si bumerang dhe ndikojn në shëndetin tonë emocional dhe mental. Shëndeti mental paraqet balancë të emocioneve besimit dhe shkathtësive. Nëse mesuesët duan që t'u ndihmojnë fëmijëve në përballimin me problemet e tyre mentale dhe emocionale, atëherë nuk është mënyra më e mirë që të përdoren propozimet: “mos u mërzi do të kaloj”, “hajde gëzohu”. Mësuesit duhet të kenë shkathtësi të caktuara për t'i ndihmuar nxënësit t'i zbulojnë dhe t'i kuptojn problemet e tyre që të mund më vonë t'i zgjedhin. Kjo nënkupton shkathtësi për dëgjim aktiv, reflektim, empati, e kështu me radhë.

Prej nxënësve me më shëndet të mirë mental pritet të zhvillojnë numër të madhë relacionë shoqërore dhe shkathtësi, si dhe të përballohen me ndryshimet në mënyrë efektive dhe emocionale. Praktika ka treguar se shëndeti emocional dhe mental ndikojn në mësimin dhe suksesin mësimor ndaj vetë pasqyrës së tyre, kurse janë faktorë kryesor në përjetimin e shëndetit të përgjithshëm të tyre dhe kualitetit të jetesës, si dhe në zhvillimin e familjes dhe mardhënive ndërnjerëzore dhe involvimin aktiv të njeriut në jetën shoqërisë.

Fëmijët me “sjellje ekstreme”. Ndhma e nxënësve për shprehjen e emocioneve

Emocionet e fëmijëve janë lëmi shumë delikate e shëndetit emocional. Emocionet e fëmijëve janë gjithashtu komplekse dhe të ndërlikuara sikurse emocionet e të rriturve. Emocionet ndikojnë dhe janë pjesë përbërëse e faktorëve të cilët janë të lidhura me veprime të ndërsjella ndaj të gjithë lëmvive në jetën e fëmijëve: të ariturat shkollore, relacionet sociale, pasqyra për veten dhe vetbesimi etj. Çdo trajtim i emocioneve fëmijërore, të cilët nga natyra janë të forta dhe intenzive, ndikon në mënyrën se si fëmija do të shfaq emocionet e veta. Përveç prindërve ose personave të cilët kujdesen për fëmijën dhe mësuesët vazhdimisht janë në situata që mund të jenë shumë të rënda dhe të papara dhe në të cilët duhet të përballohen me emocionet fëmijërore. Për atë është shumë me rëndësi mësuesët të kenë njohuri themelore, por edhe të kujdesen dhe zhvillojnë ndjenja për emocionet e fëmijëve dhe sjelljet të cilët janë pasojë nga ajo (p.sh. agresiviteti nuk është emocion por sjellje e shkaktuar nga emocionet siç janë: frikë, hidhërim, urrejtje...) Gjithashtu, mësuesët duhet të mësohen dhe të zbatojnë qasje të drejta në njohjen dhe trajtimin e emocioneve fëmijërore. Gjatë ndihmës së nxënësve të përballen me emocionet e veta dhe të flasin për problemet e veta, shumë është me



rëndësi mësuesët fillimisht ti përmbajnë emocionet fëmijërore, t'ju ndihmojnë fëmijëve t'i njohin emocionet e veta, e pastaj, nëse me të vërtetë ka nevojë të j'u ndihmojnë në kanalizimin dhe ndryshimin e tyre.

Ndrimi nuk do të thotë ndryshimi i asja se si ndihet nxënësi. Çdo emocion, edhe ai "negativ", "e rënda", "e erëta", "destruktivja", paraqesin shprehje të ndonjë të vërtete personale për nxënësin. Secili emocion na tregon diçka. Provoni të dëgjoni çfarë është porosia e emocioneve dhe mos e dënoni më ndalesa dhe dënime. Nëse fëmija është i tërbuar, ne duhet t'a pranojm dhe t'a vërtetojm këtë emocion të tij. Asgjë më tepër. Por ne mund t'i ndihmojmë fëmijës të ndron mënyrën e të shprehurit të emocionit të tërbuar. Në vend të grushtave të shfrytëzon fjalët. Në vend të "të shkundet për tokë" në frustracion, të shetis, të vizaton, të luaj me plastelin, të thot, por edhe të qajë. Jepni kurajo fëmijës të gjejë mënyrën që t'a thot porosin e vendosur në emocionet nëpërmjet ndonjë mediumi tjetër: fjala, ngjyra, frymëmarje të relaksuar, interpretoj, shëtitje e thjeshtë, të shkruaj ditar, etj.

Një anegdotë thot se Mikelanxhelo shpesh ka pasur gjendje të hidhëruar dhe zemëruar. Në këtë gjendje të urretjes e ka gërmosur mermerin e skulpturave të veta më shpejt dhe më preciz se çdo skulptor tjetër i kohës së tij. Do të thot zemërimi mund të jetë pozitiv, nëse shprehet në mënyrë tjetër nga ajo e zakonshme.

Çfarë arrihet me mbështetje në këtë mënyrë nga ana e mësuesit?

Kur të riturit kan besim te fëmijët, te ato pikësëpari e zmadhojn vetëbesimin dhe vetëpranimin. Asnjëherë nuk mund t'a teprojm, sa të përsërisim se mësuesit mund të luajn rol të rëndësishëm në ndërtimin e vetëbesimit te fëmijët, vetëm nëpërmjet ndërtimit të qendrimit ndaj fëmijve i cili involvon pranimin, kurse jo gjykimin. Nëse i pranoni në shiqim të parë emocionet destruktive, në vend që t'i dënoni, fëmija me siguri do të qetësohet. Praktika e punëtorve tën dryshëm me fëmij (psikologve, pedagogve, mesuesve, punëtorve social) thot se vetëbesimi të fëmijët e zvogëlon agresivitetin. Pas sjelljes agresive është e mshehur lëndimi, vetëmia dhe josiguria. Më mirë është të zmadhohet vetëbesimi, nëpërmjet pranimit tuaj, se sa të dënohet agresiviteti. Ose të marim gjendje tjetër emotive, për shembull, vetëmia. Ndjenja e vetëmis mund të jetë shumë e dhimbshme dhe keqe për fëmijën. Kjo ndjenjë është shpesh e lidhur me ndjenjën e largimit, jopranimit, që çon në jopranimin e vetëvetës dhe humbje të dukshme të vetëbesimit. Në vend të kësaj fëmija , të themi nëpërmjet notave të dobëta, ose tallje se është i urtë dhe i tërhequr në vetëvete, mësuesi duhet të gjejë mënyrë të krijoj atmosferë për shoqëri dhe aktivitete në të cilat ky nxënësi do jet i involvuar.

Më tutje, mësuesi me mbështetjen që u'a jep nxënësve në njohjen dhe pranimin e emocioneve, u mundëson edhe mësim si t'i shprehin emocionet në mënyrë sociale të pranueshme (si në shembullin e lartpërmendur për zemërimin). Kur fëmijët i mësojn rregullat për shprehjen adekuate të ndjenjave, që do të thot shprehje e kontrolluar dhe





jodestruktive, ata njëkohësisht mësojnë se mund të kontrollojnë mënyrën e shprehjes. Me ndjenjën e kontrolës rritet edhe vetëbesimi të nxënësit.

Edhe mësimi, si edhe zhvillimi në përgjithësi, miren si **procese relaksuese**. Kur fëmijët ndjehen të pranuar dhe vetëbesim më të madh, pothuajse, automatikisht bëhen më tepër kurioz për vete, për të tjerët, për rrethin, për botën, për lëndët mësimore. Nëpërmjet fantazisë dhe lojës së pranuar (ai “procesi ekternal i krijimi”) krijohet klima e përgjithëshme pozitive për mësim aktiv. Mësuesit e njohin dhe e përmbajnë atë që është e re dhe e papritur. Në këtë mënyrë ndërtohen diturit e reja. Domethënë, nëpërmjet lojës interaktive, e cila bazohet në pranimin e vetëbesimit të zmadhuar, mund të themi se fëmijët **zhvillohen dhe mësojnë**: edhe intelektualisht, emotiv dhe social.

Propozimet për mësuesin

- Të jeni senzitiv në raport me emocionet delikate fëmijrore. Reagoni butësisht, pa mbivlerësim dhe kritika. Fëmijët ndjehen shumë të sigurt në rrethin e tyre kur meren parasyshë emocionet e tyre, në të cilat ata lirshëm mund t'i shprehin të gjithë disponimet dhe jodisponimet e tyre.
- Respektoni dhe behuni të durueshëm me tregimin e ndjenjave negative. Jepuni kohë fëmijve t'i shprehin. Mos i ndërpritni me pyetje, sqjestione, ngushëllime...
- Ndhmoni fëmijët që t'i diferencojnë emocionet. Shpesh fëmijët janë të hutuar nga kompleksiteti i përjetimeve të tyre. Ndonjëherë është e nevojshme dikush nga jashtë, më i ritur dhe më me përvojë që t'i emërojë emocionet e tyre. Fëmijët do t'ju tregojnë a përgjigjet emëri me atë që e ndjenë. Emërimi juaj osë thjeshtë pyetja (a je i mërziur osë i inatosur?) u ndihmon që t'a kuptojnë më mirë çfarë u ndodhë atyre.
- Jepni kurajo që t'a shfrztëyojnë energjin konstruktive, që mos të lëndojnë vetën dhe të tjerët.
- Respektoni rezistencën e tyre! Mos i detyroni që të japin përgjigje osë të marrin pjesë në ndonjë aktivitet; lejoni që të lëshojnë një rrethë. Këto punëtori me emocionet mund të provokojnë përmbajtje të ndryshme delikate, shqetësuese për fëmijën. Nëse fëmija hesht dhe tërhiqet, kuptoni këtë si mënyrë e vetëmbrojtjes. Mos insistoni për aktivitet në bazë të çdo çmimi!
- Gjatë punës me emocione (të komplikuara dhe të rënda) keni besim në ju besoni potencialin e fëmijëve. Nuk qasje më të mirë nga qasja e besimitë tregoni se ju besoni në dituritë e tyre dhe çka është më së miri për ata. Provoni fëmijët!-ata do t'ju çojnë deri ku duhet (në hapsirën e brendshme të emocioneve dhe relacioneve) që pastaj ju t'ju ndihmoni dhe të ndërmjetsoni në mënyrë më të mirë. Jepuni të drejtë ata të jenë njohësit më kryesor, pjesëmarrës dhe kreator të përjetimeve të tyre. Ju jeni për ata mbështetja më e rëndësishme dhe ndërmjetsues me realitetin, por nuk jeni ekspert për përjetimet e tyre.



Dëgjimi aktiv

Komponenta kryesore që ndihmon fëmijët në përballimin e emocioneve të tyre dhe menaxhimin në klasë është komunikimi. Respektimi i bashkëbiseduesit, përpikshmëria, autentiteti dhe empatija janë shkathtësitë bazike komunikative. Këto gjithashtu janë komponenta të një aspekti të rëndësishëm të komunikimit-ndëgjimit. Secili mund të bëhet dëgjues i mirë. Dëgjimi është shkathtësi që mësohet. Dëgjimi aktiv në vete është përvojë shumë e mirë dhe mund të ndihmojë në zgjedhjen e problemeve. Dëgjimi nuk duhet të nënkuptohet si sjellje e gjykimeve. Dëgjimi aktiv nënkupton përcjellje të kujdeshme që tregohet nëpërmjet:

- Kontakti me sytë;
- Përkulja e trupit duke folur p.sh. përkulja drejt bashkëbiseduesit etj.;
- Empatia: buzëqeshja kur tjetri qesh, pakënaqësi kur bashkëbiseduesi është i pakënaqur;
- Inicime verbale: me të vërtetë?!, aha, po,po: vazhdo etj. Më mirë është të anashkalohen ndërprerjet më të gjata nëse dëshirojmë t'i japim kurrajo bashkëbiseduesit “lë lirohet”.

Ekzistojnë edhe mënyra tjera, përveç dëgjimit aktiv, për t'i ndihmuar dikujt që të flet:

- Reflektimi: i thuash bashkëbiseduesit çfarë mendon se ke dëgjuar. Ajo mund të jetë përsëritje e thjeshtë e asaj që është thënë ose koment për atë si është thënë. Psh.: “Tingëllon e hidhëruar çdoherë kur e përmend nënën tënde”;
- Përsëritje dhe sumim; dhe
- Sqarim

Pasqyra për vetveten dhe vetbesimi në procesin mësimor

Pasqyra për vetveten është koncept që e ndërtojmë prej më tepër besimeve të cilat kanë të bëjnë me veten tonë, prej të cilëve disa janë pozitiv, disa janë negativ, disa janë me rëndësi esenciale, kurse të tjerët me rëndësi më të vogël. Pasqyra për veten është një ndër bartësit themelor të shëndetit mental dhe emocional. Ajo ndërtohet dhe zhvillohet, por nuk trashëgohet. Ndërtimi i kësaj pasqyre nënkupton mësimin, hulumtimin për veten dhe është proces shumë i komplikuar për të cilin nuk jemi gjithmonë të vetëdijshëm. Sipas disa teoricientëve vetbesimi dhe pasqyra për veten varen prej përvojave tona për atë se si na trajtojnë njerëzit tjerë. Me rëndësi të posaçme janë refleksionet, vlerësimet, perceptcionet të cilët për ne kanë “rëndësi të tjerët” të cilët më së shpeshti janë njerëzit që kemi relacione të afërta personale dhe kontaktet-prindërit, vëllezërit/motrat, miqët, moshatarët, mësuesit...



Roli i mësuesit si figurë kryesore në zhvillimin e vetëbesimit dhe pasqyrës për veten

Edhe pse fëmijët në shkollë vinë me numër të madhë të perceptimeve të formuara për vetën e vet dhe për aftësit e tyre (“e kthjellët”, “dembele”, “ngadal mësoj”, “shpetjt miqësohem”...) të cilat, si një lloj etiketash që i bartin me vete nga përvojat e mëparshme, shkolla dhe mësuesët vazhdojnë të ndikojnë në formimin e pasqyrës të fëmijët që kanë për vete. Mësuesit mund të kenë ndikim të madhë pozitiv në pasqyrën për vete dhe arritjet shkollore.

Që të jenë efektiv, mësuesit duhet të mundohen të kuptojnë mundësit individuale dhe potencialet e fëmijëve dhe të parashtrojnë kërkesa reale nga ata. Me rëndësi është që të jenë të vetëdijshëm se ata dërgojnë pandërprerë mesazhe të mshefta si për shembull: “kur ka takime në mes fëmijëve, numri i kontakteve verbale me fëmijë të caktuar ose lëvdatat dhe/ose moskokëçarje, injorimi i disa përgjigjeve, të cilat fëmijët me shumë shkathtësi i komentojnë dhe i inkorporojnë për pasqyrën e tyre dhe për të tjerët. Gkithashtu gjeste të ndryshme mund të japin kurajo ose të jenë humbës për gjestet e trupit të fëmijëve të cilat i kanë mësuesit gjatë komunikimit me vetëbesimin e fëmijëve dhe për pasqyrën pozitive për veti.

Mësuesit duhet të kenë kujdes që të gjithë fëmijët të respektohen njëllë dhe të arrijnë suksese të caktuara, që do të thotë të vlerësohen arritjet e tyre. Në këtë mënyrë fëmijët mësojnë të vlerësojnë vetëvetën, por edhe të tjerët në pajtueshmëri me arritjet reale dhe sukseseve dhe përpjekjet që janë bërë, që paraqet bazë për përgjegjësi dhe pavarësi personale.

Vetëm pasqyra pozitive për veten dhe vetëbesimi të cilat janë ndërtuar në këtë mënyrë do të bëhen pjesë integrale e personit e cila nuk është egocentrike (ajo që është e orientuar vetëm për plotësimin e nevojave të veta dhe që orvatet pandërprerë të jetë në qendër të vëmendjes). Vetëbesimi dhe vlerësimi real i kualiteteve vetanake në mejdis të sigurt dhe simulativ mund të garantojnë person që din të vlerësojë edhe aftësitë dhe dallimet te/me të tjerët, e cila është e përgaditur të bashkëpunojë, të ndajë, të ndihmojë.

Krizat zhvillimore gjatë fëmijëris dhe adoleshencës. Karakteristikat dhe potenciali

Krizat nuk janë katastrofa. Krizat zhvillimore janë periudhë e ndryshueshme prej zhvillimit të personit në të cilin ndodhin ndryshime, të cilat janë rezultat nga jobaraspesha e përkohshme në mes mundësive zhvillimore të personit dhe kërkesat e mejdisit social. Krizat krijojnë energji plotësuese, të re, këto janë momente kthyesë që hapin mundësi për pasurimin dhe përforcimin e personalitetit dhe potencialet e tij për zhvillim. Pas secilës krizë të tejkaluar njeriu është më i fortë, më komplet, më i pasur. Qëllimi kryesor i secilës krizë zhvillimore është ndryshimi i ekzistueses, gjegjësisht zhvillimit.



Mosha shkollore është periudha në të cilën zhvillimi psiko-social është më pak konfliktuoz se në paraprakën dhe në të ardhëshmen. Karakteristika e kësaj periudhe është tentimi kah arritja e diturive dhe shkathtësive të reja. Ky stadij është vendimtar në aspektin social. Bashkësia e paraqitur më së tepërmi nëpërmjet shkollës e pregadit fëmijën për realitetin që e pret: i parashtron detyra, kufizime, e vendos në situat të mëson dhe të arrij dituri të reja. Në këtë mënyrë fëmijët gradualisht mësojnë t'i shfrytëzojnë teknologjit, e kuptojn kuptimin e punës, mësojnë të bashkëpunojnë. Kriza në këtë stadij ka të bëjë me relacionin punëdashës-inferioritet. Kriza tejkalohet nëse fëmija arrin sukses, dhe është i kënaqur nga arritjet e tij. Tejkalmi i krizës është i lidhur me ndjenjën e kompetencës-besimit se është i aftë me sukses të veprojë, punojë. Megjithatë, kompetenca nuk është e lidhur vetëm me shkathtësit për punë, por edhe për detyrat në komunikim, në relacion me të tjerët.

Nga na tjetër, kualiteti negativ ose inferioriteti e ngadalson fëmijën. Kjo ndjenjë mund të sjellë deri te regresioni ose të jetë bazë për tendencë të fortë kah përparimi. Ndjenja e përhershme e inferioritetit dhe inertitetit mund të krijohet nëse kriza nga periudha e mëparshme nuk është plotësisht e tejkaluar (fëmija mund më tepër të vuajë për nënën se sa të orientohet kah diturit, puna ose ajo vazhdon të krahasohet më babin, që shkakton ndjenjë të fajsisë dhe inferioritetin) ose nëse për shkak të pregaditjes jo të drejtë nga prindërit nuk është i pregaditur të jetë nxënës ose është i paknaqur për arritjet e tij si nxënës. Por, mosuksesin e arritjes së shkathtësive, mosuksesi në gjindëshmërinë, gjegjësisht mungesa e kënaqësisë nga performansa dhe përpjekjet rezultojn me inertitet.

Zhvillimi i personalitetit në periudhë tranzicioni midis fëmijërisë dhe adoleshencës

Adoleshenca është më e rëndë, njëherit edhe periudhë më emocionuese e jetës. Trupi radikalisht ndron. Njeriu i ri është me plot energji. Moshatarët dhe anëtarësimin në grupe bëhen më të rëndësishme. Vend të rëndësishëm kanë herojnë dhe idolet. Njeriu i ri balafaqohet me sfida të rënda; të gjejë vendin e tij në shoqëri, të gjejë "vetëvetën", të lidhet me të tjerët, të lenë përshtypje, të zgjedhë profesionin... Ky është periudha më e rëndësishme për ardhmërinë. Zgjedhja e konflikteve në këtë periudhë mund të jetë e ngadalsuar prej faktorëve dhe proceseve sociale, si dhe prej ndryshimeve të mdhaja sociale, politike dhe teknologjike.

Kriza në këtë periudhë është e lidhur me identitetin/identitetet. I riu mundohet të dij dhe të kompletohet, pyetet si është, si dëshiron të jetë, si mund të jetë. Nevoja kryesore e çdo personaliteti të rij është nevoja të mbindërtoj identitetin. Karakteristika e kësaj periudhe është nevoja për eksperimentim, provim, ndryshim të roleve, identitetit, grupeve, idoleve, idealeve, vlerave, pamjes... Posaçërisht me rëndësi është përshtypja dhe paraqitjen që të tjerët e kanë për atë.

Kualiteti që zhvillohet në adoleshencë është besimi-aftësia të arrij të premtuarën, të jeshë lojal. Hutimi i identitetit, konfuzioni është përvojë e partjetërsueshme, por nëse ngel si karakteristik e përhershme mund të krijojë jokualitet, gjegjësisht, braktisje që do të thotë nuk ka pasqyrë të qartë për veten, rëndë pranon rolet, frikë, hutitë, jo i aftë, shprazëtir, ndjenje të humbjes, jovendosmëri, anksozitet.

Pse është me rëndësi pranimi i karakteristikave zhvillimore dhe potencialeve për procesin mësimor?



- Të njihen dhe të përgjigjet në nevojat të cilat janë karakteristike dhe të shprehura në periudhën zhvillimore-nevojat për mësim, nevoja për lojë, zbatimje, liri, pronësi, miqësi, përmbajtje, lëvdatë, pushtet, siguri, mrojtje;
- Të dizajnohet atmosfera dhe mejdisi që mundëson tejkalimin e sigurtë të krizave;
- Të stimulohet zhvillim dhe tejkalim të kualiteteve negative;
- Të ndërtohet pasqyrë reale dhe pozitive për vetëvetën; dhe
- Të stimulohet vetëbesimi.

Nevojat e nxënësve në shkollë

Abraham Maslov thot se mardhëniet e mira me të tjerët dhe vetërespekimi i lartë janë fundamentale për të gjithë llojet e mësimin. Sipas piramidës së njohur të nevojave të Maslovit, nevojat e njeriut ekzistojnë në nivele të ndryshme, dhe për më tepër njerëz duhet patjetër të plotësohen nevojat “më të ulta”, para se të plotësohen “më të larta”. Kur njeriu do t’i plotëson nevojat themelore (më të ulta); për ujë, bukë, siguri, atëherë nevojat emocionale mund të dalin në sipërfaqe.

Nevoja bazike emocionale është të jeshë i dashur. Deri sa kjo nuk arrihet, personaliteti nuk mund të ndjehet mirë me vetëvetën.

Nevojat intelektuale duhet të ndërtohen në këtë bazë stabile emocionale. Nevojat intelektuale lëvizin prej vetë-aktualizimit deri te metanevojat.

Shkolla nuk duhet t’i ignorojë nevojat emocionale bazike dhe fizike të nxënësve dhe të punësuarve, përfundon Maslov. Njohja, respekti dhe përgjegjësia e nevojave të nxënësve është pjesë e elementeve kryesore për menaxhimin e suksesshëm të procesit mësimor.

Në studimin e rastit që është përshruar më poshtë në tekst prezantohet edhe një teori e nevojave, dhe disa nevoja bazike të fëmijëve dhe rëndësia në ballafaqimin me problemet në shkollë/klasë.





Studimi i rastit

A janë të përmbushura nevojat e nxënësve në shkollë (posaçërisht nevoja për shoqëri dhe nevoja për rëndësin, vlershmërin)?

Kjo është pyetja, përgjigjën e së cilës e kërkoi psikologu Vesna Shurkova e shkollës fillore “Johan Hajnrih-Pestaloci”, Shkup. Ajo filloi prej teorisë së kontrollit të **Vilijam Glaser**, i cili thot: “Besoj se nevoj për rëndësin është zemëra, zemra absolute e të gjithë problemeve shkollore. Sjellja e përgjithëshme njerëzore gjenerohet nga ajo që lindë në brendi të personalitetit aktiv. Me fjalë tjera, krejt çka përfitojm nga bota e jashtëme është vetëm informacionet. Pastaj ne zgjedhim si do të aktivizohemi në informacionin konkret në drejtim të cilin besojm se është më i miri për ne.

Ajo që duhet të kuptojm është se **nxënësit nuk do të mundohen në orët të cilat nuk i plotësojn nevojat e tyra**. Nevojat e nxënësve janë plotësisht identike si edhe të njerëzit tjerë. Gjatë tërë jetës, ne vazhdimisht jemi në kërkim të rrugës për plotësimin e nevojës për pronësi, dashuri, ndarje, kujdes, bashkëpunim, pushtet, liri dhe dëfrim.

Nëse nxënësi nuk ndjehet se i takon shkollës dhe nuk ka ndjenjë se i kushtohet kujdes, ai nuk do t'i kushtojë asnjë rëndësi edhe lëndëve mësimore. Në vend që t'i kushtohet arritjeve në shkollë, ai do të angazhohet në kërkim të shoqërisë dhe pranueshmërisë. Duke u munduar që t'i plotësojë ato nevoja, ai mund të fillojë edhe me sjellje problematike, me qëllim që të tërheq vëmëndje.

Teoria e kontrollit, në fakt promovon qasje jotradicionale në procesin mësimor me:

- shkallë të lartë të pajtueshmërisë, sjellje të vendimeve me konsenzus;
- përkushtimi dhe inicimi i mësuesve dhe nxënësve, lidhje;
- mësimi nëpërmjet përvojës së personalizuar, mësimi kooperativ, mësimi në ekipe;
- metodat e mësimit me varianta të hapura, me ndërtimin e pasqyrës pozitive për vetveten, si qëllim i rëndësishëm në procesin e mësimit;
- zhvillimi i qëndrimeve dhe shkathtësive, komunikimi dhe këmbimi i ideve, qëndrimet dhe besimet si variabla të ndryshueshme;dhe
- mësuesi-model në rolin e udhëheqësit, mediator, menaxher, person për mbështetje.



Metoda, mostra e të intervistuarve, instrumentet dhe rezultatet

Mostrën e përbëjnë 451 nxënës nga klasa e tretë deri në klasën e tetë të moshës 9 deri 15 vjeçare. Anketa ishte realizuar me qëllim që të caktohet numri i nxënësve të cilët është plotësuar nevoja e shoqërisë dhe nevoja e rëndësisë. Pjesën praktike (terenit) të hulumtimit e realizuan anëtarët e organizatës shkollore, gjegjësisht kryetarët e klasave. Rezultatete për çdo klasë i përpunuan nxënësit - anëtarët e organizatës së klasës, në bashkëpunim me kujdestarët e klasave. Përpunimi i rezultateve në nivel të numrit të përgjithshëm të të intervistuarve e përgatiti psikologu i shkollës. Prej pasqyrës tabelare dhe grafike të rezultateve mund të konstatohet se:

- nevoja për shoqëri është e plotësuar te 99% e të intervistuarve kurse nevoja për vlerësi te 76% e të intervistuarve;
- përqindja më e madhe e nxënësve ndjehen mirë në shkollë, kanë klimë pozitive për punë, kanë shokë dhe kanë sukses në plotësimin e nevojës për vlerë personale.

Nëse fokusohemi në rezultatet sipas klasave do të shohim se ekzistojnë klasa në të cilat nevoja për vlerë nuk është e plotësuar te më shumë se gjysma e të intervistuarve, gjegjësisht nuk kanë sukses të arrijnë vlerën personale. Si pasojë e kësaj paraqiten më tepër probleme në këto klasa, si në raport me vendosjen e klimës pozitive të punës, ashtu edhe në raport me komunikimin interpersonal dhe arritjet e nxënësve.

Rezultatet nga anketa në raport me gjendjen në klasa vetëm i vërtetoi konstatacionet e mësuesve në këshillat e klasave. Nxënësit i formuluan rezultatet e përfituara në formë të video prezentimeve, të kombinuar me teori dhe propozime të metodave, teknika dhe qasje në procesin mësimor. Prezentimi u realizua në nivel të: organizatës shkollore, organizatës së klasave dhe aktiveve profesionale të mësimin klasor dhe mësimin lëndor. Pas prezentimit të materialit para mësuesve u aplikua pyetësori për vërtetimin e mendimeve të mësuesve për aplikimin e teorisë së kontrollit në klasa me qëllim të përmirësimit të gjendjeve me nxënësit e pamotivuar dhe përmirësimin e kualitetit të arsimit. Me rëndësi është të theksohet se nxënësit dhe mësuesit në diskutimet, pas prezentimit të rezultateve, konstatuan se me aplikimin e shpeshtë të teorisë së kontrollit në shkollë dhe me organizimin e nxënësve në ekipe për punë gjatë procesit mësimor do të mund të përmirësohet gjendja me nxënësit e pamotivuar.

Propozimet deri te shkolla të të cilat ekzistojnë probleme me nxënësit e pamotivuar janë:

- trajnimi (mësimi) i mësuesve për rolin e mësuesit në zhvillimin e vetëbesimit dhe pasqyrën për veten të nxënësit, për shëndetin mental dhe emocional për karakteristikat zhvillimore dhe potenciale të nxënësve;
- zbatimi i ekipeve për mësim nëpër klasa nëpërmjet të cilit mundësohet mësimi interaktiv, kooperativiteti dhe loja;
- zbatimi i projekteve hulumtuese të nxënësve në procesin mësimor;
- trajnim (mësimi) i nxënësve prej moshës më të re se ata, si të gjithë njerëzit tjerë në botë, se ata gjithmonë mundohen t'i plotësojnë edhe atëher kur sillen mirë ose keq në klasë ekzistojnë zgjedhje që ato e bëjnë me qëllim që t'i plotësojnë gjithë nevojat e tyre.



Punëtori për shëndetin mental dhe emocional

Qëllimet

- Hapja e temës “Shkolla që e avanson shëndetin”;
- Njohja e elementeve dhe shkathtësive për dëgjim aktiv;
- “Hyrja nën likurë” e të riut - empatia; dhe
- Ndhurma nxënësve të flasin për problemet e veta.

Materiale:

- Çfarë është shëndeti? Çfarë është person i shëndoshë? Çfarë është shkollë e shëndoshë? Si mund t[avansojm shëndetin në shkollë? (Fletë për punë)
- Instruksione për dëgjim (Fletë për punë);
- Fletë të madhe letre, markerë, stilograf, fotografi nga fëmij tipik, tinxherë; dhe
- Ndhurma e nxënësve të flasin për problemet e veta dhe instrukcionet për lojën e roleve (Fletë për punë).

Aktivitete:

1. Çfarë është shëndeti: Pjesëmarësit ndahen në grupe nga 4 deri 5 anëtarësh. Secili grup i ka për detyrë në fletë të shënon mendimet për një rënë prej pyetjeve të dhëna më posht:

- Çka është shëndeti?
- Çka është person i shëndetshëm?
- Çka është shkollë e shëndetshme?
- Si mund të avansohet shëndeti në shkollë?

Pastaj , secili drup i prezanton mendimet e veta para të tjerëve. Pas sejcilit prezantim diskutohet për pyetjet: A kanë të tjerët diçka për të plotësuar? - A ka qendrime të kundërta? Në fund lideri mundohet t'i mbledhë dhe nënvizon qendrimet e grupit për secilën pyetje, duke u kujdesur për secilin mendim si më me rëndësi dhe më relevant, se nuk ka mendime të sakta dhe të gabuara. Pastaj prezantohet për qasjen holistike ndaj shëndetit dhe për atë se si shëndeti mund të avancohet.

2. Dëgjimi dhe përgjigjja aktive: Pjesëmarësit ndahen në çifte, pastaj sejcili çift shënon cili në çift do të jet A dhe B. Bisedoni për diçka që e bëni për zbatimje, por që ju intereson shumë.

- Të gjithve të shënuar me A nga çiftet të cilat qëndrojnë anash ju sqarohen instrukcionet për dëgjim dhe ju jepet të shkruajtura në letër. Përcjellni instrukcionet deri sa dëgjoni partnerin tuaj kur do të flet. Partneri juaj nuk duhet të dijë për instrukcionet që i keni ju. Le të fillojnë B të flasin me A-në.
- Pas 3-4 minutave, të gjithë ulen në rrethë dhe bisedojnë për atë si B janë ndijë kur kanë qenë të dëgjuar;
- Përsëri në çifte, por tash B marrin instrukcionet për dëgjim, të shkruajtura dhe të sqaruar. Pastaj A flasin me B.
- Pas 3-4 minutave përsëri të gjithë ulen në rrethë dhe A përshruan për përvojën si është ndirë gjatë koës së bisedës me B.



- Që mos të ngelin ndjenja negative lejoni që përsëri çiftet të vazhdojnë të bisedojnë, por tash edhe B dëgjojnë në mënyrë aktive.
- Në fletë të madhe letrë shkruhen përvojat: Si u ndjeva kur isha i/e dëgjuar? Si u ndjeva kur partneri nuk më dëgjonte? Çfarë bëjmë që të tregojmë se dikënd me vëmendje e dëgjojmë? Cilat gjeste, cila mënyrë e sjelljes na tregojnë se bashkëbiseduesi nuk na dëgjon me të vërtetë?

Diskutimi: Si dhe kur ky ushtrim mund të zbatohet në klasë?

3. Stuhi-foto: Pjesëmarësit ndahen në 4 grupe. Secili grup mer nga një fletë të madhe letrë, marker dhe fotografi e djalit ose vajzës. Fotografia ngjitet në qendër të letrës, Dy grupe në letrë shkruajnë çfarë mendojnë se fëmija nga fotografia do të ishte përgjigjur pyetjes: Çfarë më bën të njehem mirë në lidhje me vetën time? Dy grupet tjera shkruajnë për se çfarë do të ishte përgjigjur fëmija në pyetjen: Çfarë më bën të mos ndjehem mirë me vetën time, të jem i/e mërziur, i/e friksuar? Shkruajnë krejt çfarë u vjen ndër mend. Pastaj varen letrat dhe diskutohet në gjithë grupin: cilat janë ngjajshmërit dhe dallimet në lidhje me gjininë? A mund të grupohen fjalët në kategori (në lidhje me të tjerët, njerëz, shkollë, familje...) Sa është lehtë/vështirë të vendosish vetën në pozicion të fëmijës/të riut? Sa jeni të sigurtë se këto janë përgjigjet që mund t'i japin të rinjtë?

4. Ndhurma nxënësve të flasin për problemet e tyre : Pjesëmarësve ju prezantohet komponentat themelore të procesit komunikues me nxënës që ka problem. Pastaj dy vullnetar (mësues dhe nxënës) e luajnë skenën, pas kësaj pason diskutimi: Çfarë ndjen mësuesi për bisedën? Çfarë mendon se ka bërë mirë? Si mund të përmirëson komunikimin? Çfarë ndjen nxënësi për bisedën? Çfarë mendon se mësuesi ka bërë mirë? Si mund mësuesi të jetë më efektiv?





Punëtori për ballafaqimin me agresivitetin

Qëllimet

- Njohja e ndjenjave agresive të veta dhe të tjerëve;
- Kuptimi i burimit/shkaqeve për këto ndjenja;
- Mënyra e shkarkimit të ndjenjave negative;dhe
- Mësimi i mënyrës pozitive për tejkalimin e ndjenjës pozitive.

Materiale:

- Fjali të papërfunduara (Fletë për punë);
- Persona me emocione negative (Fletë për punë);
- Lista e mënyrave të pranuar dhe jo të pranuar sociale si të shprehet agresiviteti (Fletë për punë);dhe
- Marker, stilolapsa, lapsa dhe ngjyra të ndryshme.

Aktivitete:

1. Fjali të papërfunduara: Pjesëmarësit marini nga një fletë për punë “ fjali të papërfunduara” dhe kërkohet prej tyre që të japin sa më tepër që është e mundur përgjigje çfarë i bënë ata të hidhërohen, tërbohen, xheloz, armiqësisht të orientuar.

2. Persona me emocione negative: Pjesëmarësit marini nga një fletë për punë “Persona me emocione negative “ dhe e kanë për detyrë në rrethet t’i vizatojnë personat me : hidhërim, urrejtje, tërbim, armiqësi, kurse pastaj t’i numërojnë. Në gjysmën e poshtme të fletës në rrethet e shprazëta të vizatojnë persona me ndjenja të cilat janë të kundërta me hidhërimin, urrejtjen, tërbimin dhe armiqësimin, pastaj t’i emërojnë. Në fund të gjithë fletat ngjiten në tabelë ose në hamer dhe të gjithë i shiqojnë.

3. Mënyrat e pranuar dhe jo të pranuar sociale si të shprehet agresiviteti: grupa ndahet në gjysëm gjegjësisht në dy grupe të vogla. Njëri grup i vogël duhet të gjejë mënyra të pranuar sociale për shprehjen e agresivitetit (e merr gjysmën e majtë të fletës për punë “ lista e mënyrave të pranuar dhe jo të pranuar sociale si të shprehet agresiviteti”), kurse grupi tjetër i vogël duhet të shkruaj mënyrat e pranuar sociale për shprehjen e agresivitetit, kurse pastaj t’i rradhite në gjysmën e djathtë të fletës për punë.(në listat si shembull u është dhënë disa ide nismëtare. Ju thoni që të mëndohen dhe të theksojnë sa më tepër që është e mundur ide të këtitilla!). Secili në grup zgjedh nga një mënyrë të pranueshme për shprehjen e agresivitetit që të interpretojë para të tjerëve.

4. Fantazia e udhëhequr - lugina e lumturisë : Pjesëmarësit ulen në formë të rrethit dhe j’u thuhet të relaksohen. Kjo bëhet me disa frymëmarrje të thella me mbajtjen e ajrit dhe numërim deri në shtatë derisa e nxjerrin ajrin. Atëherë udhëheqësi u thotë që t’i mbyllin sytë dhe të përsjellin fjalët e tij, me të cilat ai do ti dërgojë në “luginën e lumturisë”



“Paramendoni se udhëtoni nëpër një tunel. Është erët dhe për njëherë u bëhet dritë para syve dhe vëreni se ka zjarr në tunel. Muret digjen, por ju e dini se jeni të sigurt. Arrini deri në fund të tunelit dhe vëreni një derë. E hapni derën dhe hyni në “Luginën e lumturisë”. Zjarri dhe erësira janë pas. Kurse para shtrihet lugina. Ka shumë gjëra për të cilat vetëm keni ëndëruar që t’i bëjni, por nuk keni patur mundësi.

Tash e keni këtë mundësi, bëni ato gjëra! Më tutje është lumi, kurse në qendër të lumit është një ujdhesë. Njerëzit me të cilët jeni hidhëruar janë në ujdhesë. Përshëndetni ata! Ata nuk mund t’ju afrohen, as t’ju bëjnë diçka, ata nuk mund t’a kalojnë lumin dhe të vinë në “Luginën e lumturisë”. Kthehuni dhe knaquni në Luginën për një kohë. Kur jeni gati, mund t’a braktisni “luginën e lumturisë”. Tash jeni të freskuar dhe të qetësuar. Nuk jeni më të hidhëruar dhe të shqetësuar.





Punëtori për hiperaktivitet

Qëllimet

- Njohja e ndjenjave agresive të vetës dhe të të tjerëve;
- Kuptimi i burimit/shaqeve për këta ndjenja; dhe
- Mënyra e shkarkimit nga ndjenjat negative.

Materiale:

- Sigurimi i hapsirës për realizimin e ushtrimeve; dhe
- Sheqerka, fleta të letrës me ngjyra (si dhurata)

Aktivitete:

1. Loja hyrëse: Pjesëmarësit ndahen në çifte dhe në sejcilin çift ndrohet udhëheqësi, kurse tjetëri e dëgjon, pastaj i ndrojn rolet. Udhëheqësi jep urdhëra, kurse tjetëri i respekton. Ja disa shembij:

- Kërce lart-posht tre herë!
- Rrotullohu rreth tavolinës!
- Këndo si zog!
- Thuaj emërin tënd tre herë!
- Përkulu përpara tre herë!

2. Tregimi: ‘Lundrimi’: Pjesëmarësve u jepet instrukcion se duhet me kujdes të dëgjojnë një tregim, pa folur. Tregimi zhvillohet në këtë mënyrë: “Një ditë të bukur me diell shkuam për lundrim me barkë. Ishte mëngjes dhe valët nuk ishin të mëdhaja, dhe barka nuk lëkundej shumë. Era ishte e qetë dhe filluam të gjuajm peshq. Si afrohej dita me diell kah mesdita, valët bëheshin sa më shumë të mëdhaja, barka sa më shumë luhatej. Por peshku kapej në grep dhe ne vazhduam ende të gjuajm. Valët bëheshin më të larta dhe atëherë afër barkës vërejtëm një balenë të madhe. Me balenën u shiquam sy më sy dhe aq u friguam saqë menjëherë e ndruam drejtimin. Era frynte sa më fortë, valët ishin sa më të mëdhaja, kurse ne shpejtonim kah bregu të frikësuar prej balenës së madhe. Kur arritëm në breg ishim shumë të lumtur. Dita ishte ende e bukur dhe me diell. Për këtë shkak vendosëm që të shfrytëzojmë kohën dhe të gjuajm peshq dhe të vështrojmë detin nga bregu”.

Pastaj iu tregohet se disa fjalë duhet ti tregojnë me lëvizjen e duarve dhe fytyrës. Shkruani këta fjalë në dërrasë ose në fletë letre të madhe.

Ditë me diell= rreth me duart përreth fytyrës

Barka = të dy duart e drejtuara dhe të bashkuara mbi kokë dhe lëkundje e trupit

Valët = lëkundje e gjithë grupit

Balenë e madhe = dy fëmijë afrohen dhe sikur notojnë bashkë

Era = fishkëllimë me gojë



Sy më sy = rrathë me gishtërinj përreth syve

Pastaj përsëri do t'ua lexoni tregimin dhe kur shqiptohen fjalët e dhëna në dërrasë, fëmijët duhet t'i interpretojnë lëvizjet e caktuara që i simbolizojnë ato fjalë. Gjatë leximit të ardhshëm në vend që të thuhet fjala interpretohet lëvizja që simbolizon atë. Kështu p.sh. "Një ditë e bukur...(lëvizja adekuate) shkuam të gjuajm me...(lëvizja adekuate). Mund të luhet si lojë, kush do të gabojë në lëvizjet do të dalë prej lojës. Fëmijët që do të ngelin në lojë edhe pas leximit të tretë ose të katërt, fëmijët marrin dhurata të vogla (sheqerka, letra me ngjyrë etj.).

3. Loja përfundimtare: Loja përfundimtare performohet (luhet) në çifte. Nga dy fëmijë ulen në dysheme me shpinë të kthyer kah njëri-tjetri, duke u mbështetur mes veti. Duhet të ngrihen në pozitën e drejtë pa u ndihmuar me duart, por duke u mbështetur njëri për tjetrin. Nga pozita e drejtë përsëri duhet të kthehen në pozitën e mëparshme, pa u ndihmuar me duart. Ata që do të kenë sukses herën e parë në këtë aktivitet do të fitojnë dhuratë dhe do të lëvdohen me zë.



Komponenta multikulturore në procesin mësimor - respektimi i dallimeve dhe ngjajshmërive

Kultura është shenja jonë, identiteti dhe përkatësia jonë si dhe sjellja si sillemi, si vishemi, si paraqitemi para të tjerëve, muzikën që e dëgjojmë, gjuhën që e flasim,...

Kultura është sistem i normave dhe vlerave të miratuara nga ana e grupit të caktuar social që i "detyron" përfaqësuesit e grupit të sillen në mënyrë të caktuar. E kuptuar në këtë mënyrë, kultura përfshin shumë aspekte nga jeta siç janë:

- Çfarë konsiderohet për "mirë", kurse çfarë për "keq"?
- Si janë raportet në mes meshkujve dhe femrave brenda dhe jasht familjes?
- Si janë raportet në mes pridërve dhe fëmijve, në mes më të moshuarve dhe të rinjve?
- Cila gjuhë flitet?
- Cilata zakone konsiderohen si të rëndësishëm?
- Çfarë ushqimi përdorin zakonisht dhe si ushqehen?
- Si barten informacionet?
- Si shprehen emocionet?
- Kush ka pushtet dhe si arrihet deri te pushteti?
- Si është roli i religjionit?

Nëpërmjet procesit të socializimit, fëmija i kupton simbolet dhe shenjat e kultërës së vet.

Në kushtet e sotshme, është numri i vogël i vendeve që janë monokulturore, për arsye se shumica e shteteve që dikur kanë qenë monokulturore në ndërkoh janë shëndruar në multikulturore (kultura të ndryshme që rrjedhin nga grupet e ndryshme etnike dhe/ose religjioze që jetojnë në teritor të njëjtë). Në shoqëritë multikulturore grupe të ndryshme etnike mund të jetojnë në një teritor bashkarisht, duke kultivuar mardhënie të hapura të ndërsjella dhe duke respektuar njëri tjetrin. Por ka shembuj në shoqëritë multikulturore ku dallimet nuk pranohen, grupet e ndryshme kulturore që jetojnë në një teritor distancohen njëri prej tjetrit. Për këtë arsye në terminologjin moderne fjala multikulturore zavendësohet me interkulturore, posaçërisht kur duhet të theksohet se bëhet fjalë për kultura të cilat janë mardhënie të ndërsjella (në bashkëpunim) në vend për kulutura që jetojnë njëra pran tjetrës.

Edukimi efektiv multikulturore e nënvizon rëndësinë e logjikës së brendëshme të të gjitha pjesëve të kulturës, e lidhur për kontekstin bashkues gjeografik-kohor. Ajo nuk e mer kulturën si etnitet homogjen. Gjatë kësaj, mund t'u ndihmohet nxënësve që ti kuptojnë dhe ti pranojnë dallimet që ekzistojnë në çdo kulturë, duke theksuar krenarinë e njerëzve dhe duke zhvilluar te nxënësit respekt ndaj aftësive të tyre të balafaqohen me kohën në të cilë jetojnë.



Promovimi i integritit. Perceptioni i tjetrit

Si do të sillemi ndaj ndonjë njeriut, sendit, dukurie, ngjarje, varet shumë prej asaj si perceptojm. Perceptimi është proces i cili n'a mundëson atë që truri jonë e pranon si bashkësi nga ngacmimet e veçanata (për shembull, njeriu). Njekohësisht perceptimi përfshinë edhe vlerësimin, duke na mundësuar për njeriun që e vërejmë të themi se është i lartë, i ulët, i bukur, i shëmtuar, i mirë, i keq... Sjellja jonë ndaj atij ka ndikim të madhë në atë se si e perceptojm - nëse e kemi perceptuar si të keq, ndaj atij do të sillemi ndryshe, prej asaj nëse e kemi perceptuar si të mirë.

Në perceptimin ka ndikim përvoja e mëparshme dhe pritjet. Nëse me dikënd kemi pasur përvoj negative dhe pozitive, presim që ai të sillet në atë mënyrë ngaj nesh në të ardhmen. Nxënësi që ka marë 5 në fillim të viti shkollor, mund të knaqet në lavdinë e kaluar. Interesat dhe vlerat ndikojn dhe i ngacmonë njerëzit që mos të shohin atë që duhet të shohin. Për shembull, një qen, dikush e shiqon si rrezik, kurse dikush si kafshë shtëpiake.... Te njerëzit ekziston tendenca që t'a perceptojn situatën vetëm nga perspektiva e tyre. Për këtë shkakë, njerëzit e ndryshëm shiqojn veti të ndryshme të një subjekti të njëjtë dhe njerëzit e ndryshëm e përshkruajn një ngjarje të njëjtë në mënyrë të ndryshme.

(adaptuar nga Beshka B. (1999) "Respektimi i dallimeve")





Punëtori për “Diçka tjetër”

Qëllimet

- Të paraqitet në mënyrë të thjeshtë dhe ilustrative (jo) pranimi i Tjetërit;
- Të inicohet diskutimi për dallimet;
- Të promovohet pranimi i dallimeve;
- Të qartësohet se njerëz të ndryshme mund të shiqojnë ndryshe personin e njëjtë, lëndë të njëjtë, dukuri të njëjtë, ose ngjarje; dhe
- Të vërehet se ajo që perceptohet varet nga përvoja e mëparëshme, nga pritjet, interesat dhe vlerat;.

Materiale:

- Tregimi për “Diçka tjetër”;

Aktivitete:

Leximi i tregimit për “Diçka tjetër” dhe diskutimi për termin perceptcion dhe “Diçka tjetër” - Pse ‘Diçka tjetër’ nuk u praniu si “Diçka tjetër”? Si mund të lidhet tregimi me jetën e njerëzve?



Gjeneralizimet dhe stereotipet

Të gjithë njerëzit kanë tendencë të gjeneralizojn (nxjerrin përfundime) për vetitë e gjithë grupit në bazë të përvojave me një ose me disa anëtar të grupit. Gjeneralizimet e këtilla gjithmonë bazohen në informacione të pjesërishme për grupin, kurse ka të bëjë me gjithë anëtarët të grupit. Në fakt gjeneralizimi i këtill është mendim jo i logjikshëm.

Gjeneralizimet e mësuara, posaçërisht nëse janë negativ, shumë shpesh fiksohen në kokat e njerëzve dhe shëndrohen në stereotipe. Stereotipet pamundësojnë njerëzve të vërehet si personalitet me vetitë personale, por gjithëmonë si përfaqësues të grupeve tjera.

Prania e stereotipeve për “të tjerët” e prirë nga tendenca që të perceptohen vetëm ato veprime të “të tjerëve” që janë në pajtueshmëri me stereotipet e aprovuara. Dhe jo vetëm kjo. Stereotipet i detyrojnë njerëzit të sillen ndaj personave sikurse ndaj grupit të caktuar, në pajtueshmëri me vetitë stereotipe që i përshkruhen grupit. Për shembull: nëse dikush ka stereotip se rinia është e paedukuar dhe papjekur për vendosje të pavarur, gjasat janë të mdhaja ai t’i “vëren” vetëm gjestet e paedukuar dhe të papjekura të rinjve dhe me ata të komunikon si me të paedukuar dhe nuk do t’ju lejoj vetë të vendosin.

Paragjykimet dhe diskriminimi

Paragjykimet janë qëndrime logjike të pabazuara të cilat janë mirëmbajtur me përkushtim dhe janë të pasuar me emocione ndaj objekteve të caktuara. Objektet ndaj të cilëve janë orientuar paragjykimet mund të jenë grupe (gjinitë, etnike, religjionet, etj.) ose sende dhe dukuri (shembull paragjykimet ndaj kontracepcionit, ndarja e gjilpërave..).

Paragjykimet kanë: komponentën e diturisë, emocionale dhe biheviorale: “ E di se gjithë shqipëtarët janë të pamoralshëm dhe të rrezikshëm, për këtë shkakë në shoqëri me ata ndjehem keq dhe do t’ja ndaloj fëmijë tim të shoqërohet me shqiptarët”.





Punëtori për ngjajshmërit dhe dallimet

Qëllimet

- Vëretja e dallimeve dhe ngjajshmërive në mes njerëzve; dhe
- Të inicohen pjesëmarësit që t'i shiqojn dallimet si përfitim pozitiv, pa insistuar në nevojën që të kërkohen ngjajshmërit në bazë të çdo çmimi;

Materiale:

- Fletë të shprazët letre për secilin pjesëmarës; dhe
- Fletë për punë "Vërej dallimet dhe ngjajshmërit"(Fletë për punë)

Aktivitete:

1. Loja hyrëse: Secilit pjesëmarës i jepet nga një fletë të shprazët letre. Aktivitetin e zhvillon secili i pavarur, pa shiquar te tjetëri. Të gjithë duhet t'i ndjekin instrukcionet e liderit dhe për këtë shkak duhet të ket qetësi, pa parashtruar pyetje.

Pjesëmarësit i ndjekin këto udhëzime:

- Merëni fletën e letrës!
- Theni në gjysëm!
- Grisni skajin e djathtë të epërt!
- Përsëri theni fletën për gjysëm!
- Grisni skajin e djathtë të epërt!
- Përsëri theni fletën për gjysëm!
- Grisni skajin e djathtë të epërt!
- Përsëri theni fletën për gjysëm!
- Grisni skajin e djathtë të epërt! (nëse mundet, nëse nuk mundet nuk është patjetër)
- Hapeni fletën e letrës!
- Pjesëmarësit shiqojnë për rreth dhe i shiqojn fletat e të gjithëve ashtu që konstatojn se ato dallohen.

Diskutimi:

- A dallohen fletat?
- Pse jane të grisura ndryshe?
- A është ndojnë fletë e grisur në mënyrë të drejtë, kurse ndonjëra e padrejtë?
- Nëse fletat e pjesëmarësve janë të grisura ndryshe nga e jotja, a do të thot kjo se ata janë të kqija? Pse jo?
- A gjykojm shpesh për njerëzit se janë të mirë apo të kqinj sipas asaj a i bëjn punët sikurse ne?
- A e shiqojn njerëzit nga vende të ndryshme, rasa të ndryshme, ndryshe botën? Cili shiqim është isaktë?
- Si do të duket bota nëse të gjithë do të kishim shiqim të njëjtë për të gjithë?



2. Skulptura: Zgjedhëni tre pjesëmarës të cilët në marrëveshje mes veti do të paraqesin skulpturë që asocon në “paqë”, “shoqëri”, ose në diçka të njejtë., pa koment gjatë kësaj.

Kur skulptura do të jet gati, pjesëmarësit e tjerë duhet që t’a emërojnë secili sipas mendimit të vet dhe t’a shënon në letër.

Secili me zë duhet që t’a lexon emërin e tij që i ja ka vendosur skulpturës.

Vetë pjesëmarësit në bërjen e skulpturës, gjithashtu, i japin emër skulpturës së tyre.

Diskutimi: Sejcili pjesëmarës e ka dhënë emër të ndryshëm të njëjtës skulpturë. Çfarë do të thotë kjo? A ka komentime të sakta dhe të pasakta të skulpturës? Çfarë mund të ndikoj në njerëzit që të komentojnë ndryshe sendet që i shohin? (Ndjenjat e tyre momentale, përvoja që e kanë, përjetimet që i kanë nga më parë, vlerat personale, etj.)

3. Vërej ngjajshmëri dhe dallime: Prej pjesëmarësve kërkohet që të plotësojnë “Vërej ngjajshmërit dhe dallimet”. Kur do ta plotësojnë fletën për punë, formohen grupe të vogla nga 4-5 pjesëmarës. Pjesëmarësit marrin për detyrë që t’i krahasojnë përgjigjet në kuadër të grupeve të vogla.

Diskutimi: Çfarë e kishi më lehtë të formuloni, ngjajshmërit ose dallimet? Pse? Krahasuar me të tjerët në grup, a ishin përgjigjet më tepër të njëjta apo të ndryshme? Pse? Në cilat kategori kishi përgjigje të njëjta? (A përputheni në dallimet apo ngjajshmërit?).





Punëtori për paragjzimet dhe stereotipet

Qëllimet

- Vëretja e asaj si kufizimet çojn deri te krijimi i paragjykimeve dhe stereotipeve.

Materiale:

- Fletë të madhe letre_Fletë për punë për rangim grupor; dhe
- Markerë

Aktivitete:

1. Loja hyrëse

2. Leximi i tregimit Jono Oko dhe Hai

3. Rangimi individual dhe grupor i personazheve të tregimit: Pas leximit të tregimit Jono Oko dhe Hai pjesëmarëseve u ndahen instruksione në cilën mënyrë individuale t'i vlerësojnë (rangojnë personazhet). Gjatë kësaj mund të ilustron duke vizatuar në fletë të madhe letre.

“Ka pesë nota dhe pesë personazhe. Personazhit tuaj më të adhuruar (atij që më tepër ju pëlqen) jepni notën më të madhe - 5. Ai që më pak u pëlqen - 1. Notoni secilin personazh”.

Kur çdo njeri mbaron me notimin i tregon notat e tij të cilat i shënon në fletë të madhe letre (fletë për punë). Gjatë kësaj sqarohet pse është ajo renditje, gjegjësisht cilët janë shkaqet e rangimit të këtyllë të personazheve të tregimit (rangim grupor).

Kur kryhet rangimi grupor i personazheve të tregimit, fillohet me leximin e plotësuesin - sqarimin të kontekstit të ngjarjeve.

Pason diskutimi. Si janë reaksionet e pjesëmarësve në lidhje me atë që e kanë dëgjuar në atë moment? Çfarë na tregon kjo në lidhje me mënyrën e formimit të gjykimeve? Biseda për kufizimet të cilat i vendosim vet për veten tonë. E patjetërsueshme është që të njihet konteksti në cilin njerëzit veprojnë për t'i "lidhur pikat".



Konfliktet

Konfliktet janë pjesë përbërëse të jetës: dukuri e cila është rezultat nga ekzistimi i njëkohshëm i sjelljeve të kundërta dhe intereseve të ndryshëm në mes dy ose më tepër palëve.

Deri te konflikti vjen gjithmonë në jetën e përditshme të njerëzve. Konfliktet janë pjesë e natyrshme, e pashmangshme dhe normale e jetës, në familje, në shkollë, në vend pune dhe gjithkund ku njerzit veprojnë në interakcion. Në këtë fëmijë nuk janë përjashtim - shpesh ato vet janë dëshmitarë ose pjesëmarës direkt në konflikte. Konfliktet e hapura, të pasuar me grindje, ofendime dhe rahje, nuk janë gjëra të vetme që duhet të zgjedhen. Më të shpeshtë, por edhe më shqetsuese janë konfliktet e fshehura në të cilët fëmijët dhe të rriturit tërhiqen dhe pa manifestime të jashtme i përjetojnë padrejtësitë. Derisa nuk mundësohen këto konflikte të fshehura të bëhen të hapura, nuk mund të pritët që të zgjidhen. Konfliktet janë të pashmangshëm, por hidhërimi, tërbimi, ofendimet, akuzimet dhe mosbesimi mund mënjanohen. Krejt varet nga ajo si reagohet në situata konfliktuoze dhe si do ti qasemi zgjedhjes së konflikteve. Në praktikën tonë të përditshme dominojnë disa qasje, të cilat në bazë janë destruktive ose për një palë, ose për palën tjetër, ose për të dy palët. Kështu disa fëmijë (edhe të rritur) kur kanë konflikt me të tjerët, të edukuar sipas proverbës popullore “më i mençuri tërhiqet” reagojnë në mënyrë që imponon tërheqjen dhe braktisjen e konfliktit. Ata nuk din si të komunikojnë që të kenë mirkuptim në mes veti, respektim dhe zgjedhje reale të konfliktit. Në situatat kur të rriturit involvohen për të ndihmuar zgjedhjen e konfliktit, qasja shpesh herë është destruktive. Zakonisht ata gjykojnë kush ka të drejtë, në bazë të vlersimit personal se çka është e drejtë, propozojnë masa ndëshkuese edhe i dënojnë palët për aktivitetet e ndërmara. Në këtë mënyrë ata e marrin rolin e gjykatësit, në vend që të veprojnë si ndërmjetsues, të cilët do ta kishin lehtësuar komunikimin në mes palëve të konfrontuara dhe ju mundësojnë atyre të arrijnë deri te zgjedhja e pranueshme për të dy palët.

Analiza e konflikteve duhet të përfshijë kuptimin e natyrës së konflikteve, nëpërmjet faktorëve që i shkaktojnë, i mirmbajnë dhe i forcojnë konfliktet (sjellja, nevojat, perceptioni, emocionet, paragjykimet dhe stereotipet), deri te strategjitë për zgjedhjen konstruktive (bisedime kolaborative dhe ndërmjetsim). Nxënësi duhet të mësojë ti analizojë konfliktet, të vendosë si do të sillët në situata konfliktuoze dhe të ndërmerë përgjegjësi për pasojat e sjelljes së vet. Kjo kontribon në shëndetin mental të personave, por edhe për krijimin e klimës pozitive në komunitet.

Nëpërmjet diskutimit nxënësit këmbëjnë mendime të ndryshme dhe i nxjerin konkluzionet...



Konfliktet përmbajnë dimensione pozitive - elementet për zgjedhjen e konfliktit janë të përmbajtur në vet konfliktin. Asnjë konflikt nuk mund të zgjidhet pa përballjen konstruktive me të. Përballja paqësore me konfliktin është përfitim pozitiv - vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe shprehjes paqësore të dallimeve që kanë sjellur deri në konflikt mund të arrihet ajo që me të vërtetë kërkohet. Zgjedhja e konfliktit me forca vetanake është më efikase se zgjedhja me ndërmjetsimin e palës së tretë. Ajo është shprehje e pushtetit - palët e konfrontuara e marrin përgjegjësinë për zgjedhjen. Kjo është shumë me rëndësi për të rinjtë të cilët ndjehen të paaftë. Dallimet mund të jenë pozitive - nuk janë negative sipas natyrës së tyre - konflikti është mundësi që të mësohet më tepër për veten dhe për të tjerët.

Nxënësit do të mësojnë të jenë **kooperativ**, e zhvillojnë **vetëdijen dhe afirmacionin** - i njohin anët e mira, aftësitë dhe kualitetet e vetvetes dhe të tjerëve, që u ndihmon të ndërtojnë pasqyrë pozitive për veten, njekohësisht duke mësuar si ti shprehin ndjenjat e veta, frikën, nevojën duke i respektuar gjatë kësaj të drejtat e të tjerëve, arijnë **shkathtësi komunikative** - shkathtësi për dëgjim aktiv, që është parakusht për këmbim efektiv të mendimeve, të parafrazohet folësi, të reflektohen ndjenjat e tij dhe **marëdhënia toleruese** ndaj mesit - pranimi i dallimeve në mes njerëzve.

6 hapat për zgjedhjen (transformimin) e konfliktit:

1. Identifikimi i nevojave (“Çka është ajo që ju duhet, ose çfarë dëshironi?”). Secili person në konflikt duhet të përgjigjet kësaj pyetje, pa e akuzuar personin tjetër.
2. Definimi i problemit (“Çfarë mendoni se ku është problemi?”). Gjithë klasa mund të ndihmojnë të japin përgjigje që i përfshin nevojat e të dy palëve, pa akuza. Personat që janë në konflikt pajtohen të pajtohen me definicionet.
3. Stuhia e ideve për numër të madh të zgjedhjeve të mundshme (“Kush mund ta mendojë mënyrën me të cilën mund të zgjedhet ky problem?”). Secili në klasë mund të ofroj përgjigje. Të gjitha duhet të shënohen, pa komentime, vlerësime dhe gjykime. Qëllimi i këtij hapi është që të arrihet deri te më shumë zgjedhje.
4. Evaluimi i zgjedhjeve (“A do të ishi të lumtur me këtë zgjidhje?”). Secila palë Në konflikt e analizon listën e zgjedhjeve të mundshme dhe tregon se cila për atë është e pranushme, kurse cila nuk është.
5. Sjellja e vendimeve për zgjedhjen më të mirë (“A pajtohen të dy palët me këtë zgjedhje?” “A është zgjidhur problemi?”). Vërtetohemi se të dy palët pajtohen dhe u japim mirënjohje për mundin që e kanë dhënë për zbulimin e zgjedhjes.
6. Vërtetimi i asaj se si do të funksionoj zgjedhja (“Eja të bisedojmë njëri me tjetrin përsëri që të shohim se problemi me të vërtetë është zgjidhur”). Duhet të bëhet plan se si të evaluohet zgjidhja. Evaluimi mund të bëhet për disa minuta, për një orë ose ditën e nesërme, javë, në varësi prej natyrës së konfliktit dhe moshës së njerzive që janë të involvuar në konflikt.

(adaptuar nga Beshka B. (1997) “Arsimi për zhvillim”)



Punëtorja për transformimin e konfliktit

Qëllimi:

- Zhvillimi i shkathtësive për transformimin e konflikteve

Materiali:

- Fletë për punë për transformimin e konfliktit.

Aktivitetet

Pjesëmarësit zgjedhin konfliktin që duhet ta transformojnë. Ndahen rolet për “pjesëmarësit” në konflikt dhe për mediatorët. Mediatori i përcjell gjashtë hapat për zgjedhjen e konfliktetve dhe mundohet që ta zgjedh konfliktin. Pason diskutimi për procesin.






Emblema personale


Çka bën në kohën e lirë?

Çka të plotëson në punë?



Çka don të arish?

Shkruaj diçka për familjen.



Shkruaj ndonjë fjalë të urtë, frazë, moto, etj




4

Tregim

Vizatim

3


2 Tregim





1

Vizatim





6

Tregim

5

Vizatim





**Hulintimi i hënës**

Ju jeni në ekipin e kosmosit i cili duhet të takohet me anije tjetër kosmike në pjesën e ndriçuar të hënës. Për shkak të problemeve teknike, anija juaj është e detyruar të aterojë në vendin i cili është 200km më larg se vendi ku duhet të takoheni me anijen tjetër. Gjatë kohës së aterimit shumica e mjeteve dëmtohen. Duke pasur parasysh se mbijetesa juaj varet nga ajo se a do të vijë anija tjetër, duhet të merni atë që është më e nevojshme për ju. Më poshtë janë të theksuar 15 mjete që nuk janë të dëmtuar pas aterimit. Vendosni numrin 1 afër mjetit më të rëndësishëm, numrin 2 të tjetrit me rëndësi, dhe kështu me rradhë deri në numrin 15, i cili është më pak i rëndësishëm.

Mjetet	Rangimi individual	Koncenzusi grupor
Kuti shkrepëse		
Ushqim i koncentruar		
15m pe najlloni		
Parashutë		
Nxehmëse		
Dy revole me kalibër 45		
Qumsht në pluhur		
Dy enë me oksigjen		
Harta e yjeve		
Barkë për shpëtim		
Kompas magnetik		
22 l ujë		
Revole sinjalizuese		
Ndihma e parë me gjilëra injeksionesh		
Radio pranues-emitues		



Përgjigja e ushtrimit nga ana e NASA-s

Rangimi	Mjetet
15-nuk ka oksigjen, nuk mund të shfrytëzohet në hënë	Kutia e shkrepës
4-mund të jetohej një kohë pa ushqim	Ushqim i koncentruar
6-ndihmon gjatë udhëtimit nëpër terrenin e rëndë të hënës	15m pe najlloni
8-mund të shfrytëzohet për bartje të gjërave ose njerëzve të plagosur, por në hënë përparësi për hije sepse dielli është shumë i nxehtë	Parashutë
13-ana e ndriçuar e hënës është e nxehtë, por nxehmësja mund të jetë e nevojshme për hijet e rënda nga ana e erët. Ka sistemin e vet të mbushjes	Nxehmësja
11-mund të shfrytëzohen për t'u lidhur me penin që të hudhen mbi	Dy revole të kalibrit 45
12- nuk është mirë për shkak se duhet të përzihet me ujë, kurse uji është shumë i shtrenjtë	Qumshti pluhur
1- në hënë nuk ka ajër	Dy enët me oksigjen
3-është e nevojshme navigacioni dhe caktimi i lokacionit dhe kahjes	Harta e yjeve
9-mund të shfrytëzohet si mburojë ose për bartjen e të plagosurve	Barka për shpëtim
14-fusha magnetike në hënë është e ndryshme nga ajo e tokës, për këtë shkak nuk ka vlerë, por gjendet para shkrepës dhe për këtë shkak metali i kompasit mund të shfrytëzohet	Kopmasi magnetik
2-nuk mund të jetohej pa plotësimin e lëngut në trup	22 litra ujë
10-shfrytëzohen edhe pse nuk mund të digjen pa oksigjen	Revole sinjalizuese
7-mund të shfrytëzohen për plagosje dhe sëmundje, por gjilpërat janë të pavlefshme (janë të vendosura për tërheqjen e vëmendjes)	Ndihma e parë për gjilpëra me injeksione
5-për komunikim me anijen tjetër. Edhe pse radioja e përcjell vijën e dritës dhe nuk do ta përcjell lakoren e hënës, dhe për këtë shkak shfrytëzohet vetëm në malet e larta ose kur anija tjetër është në lartësi	Radio marësi - emituesi



Krijimi i orës demokratike

...Kiti nuk ndjehej mirë në rolin e autoritetit. Ai kuptoi se metodat e tij të ligjërimit kultivojnë sjellje dhe vlera të kundërta me idealet demokratike. Këtë njohuri gradualisht e solli deri te ajo që ta ndërtojë qasjen e ligjërimit nga matematika.

Katër temat kyçe u inkorporuan në bazën e qasjes së re që ai e aplikoi: komuniteti, sjellja bashkërisht e vendimeve, mësimi me bashkëpunim dhe zgjedhja individuale dhe grupore e problemeve. Që nga dita e parë të shkollës, Kiti filloi ti përpunojë këto tema. Ai me përkushtim punoi që të ndërtojë bazën për këtë lloj të mësimi i cili shpresonte të plotëson, gradualisht duke u ndihmuar nxënësve ti zhvillojnë shkathtësitë të cilat janë të patjetërsueshme për funksionimin e suksesshëm të orës bazuar në principet demokratike. Derisa qëllimet e tij në lidhje me këtë ishin të qarta, ngeli fleksibil i kujdesshëm në hapërimin dhe i ndijshëm në nevojat të veçanta individuale dhe grupore. Së pari, ai i thiri nxënësit të ulen në formë të rrethit, i cili njëkohësisht është simbolik dhe funksional. Rrethi simbolizon dëshirën e ndryshimit të marrdhënieve të pushtetit në klasë. Funkcionalisht struktura fizike e rrethit i inicon nxënësit të jenë interaktiv, si me njëri-tjetrin ashtu edhe me mësuesin, e kundërta nga ajo tradicionale qëndrimi i mësuesit si kryesor në klasë. Gjithashtu ai shkoi edhe më larg duke sfiduar dinamikën tradicionale:

Ne sëbashku i bëjmë rregullat. Sëbashku sjellim vendimet për disiplinë. Vendosim për teknikat e vlerësimit...rëndë është sëbashku të zgjedhim përmbajtjen mësimore - por unë u tregoj atyre se disa punë janë jasht kontrollit tim dhe të atyre. Kjo është ora për algjebër dhe për këtë shkak mësojmë algjebërën. Por sa është e mundur më tepër ju lejoj atyre të caktojnë shpejtësinë me të cilën e ndryshojmë materialin, gjatësinë e detyrave të shtëpisë dhe gjërave të njëjta si kjo.

Ai fillon me sqarim të qartë të qëllimeve të tij në orë: arsyeja kryesore për të cilën grupi e mëson matematikën. Ai beson se që të realizohet kjo, me rëndësi është që nxënësit të zhvillojnë ndjenja të bashkimit dhe aftësi të punojnë në mënyrë kooperative, për shkak se rezultatet më të mira në mësim arrihen kur personat dhe grupi i shfrytëzojnë të gjithë resurset në disponim të grupit dhe ata jashtë tij. Ai e jep definicionin e vet për bashkësinë e klasës:

Ajo është grup...e cila çmon dhe i pranon dallimet e mendimeve anëtarët e së cilës e ndajnë përkushtimin e qëllimeve dhe procedurave të përbashkëta, anëtarët e së cilës janë përgjegjës për mësimin e vet dhe për mësimin e secilit person në klasë, e cila funksionon në bazë të konkonzusit, e cila e sheh veten si grup të liderëve dhe e cila ballafaqohet në mënyrë konstruktive me konfliktet.

Ai qartë tregon se prej tyre pret të marrin më tepër përgjegjësi për mësimin e vet. Që të ndodhë kjo, kryesore është që të gjithë në klasë të zhvillojnë respektim të ndërsjellë dhe besim për arsye se do të mësojnë njëri prej tjetrit. Këto qëndrime janë të rëndësishme për mësimin e nxënësve aq sq edhe shkathtësitë dhe dituritë specifike nga algjebra dhe gjeometria.



Ai e thekson nevojën për atmosferë të relaksuar ku të gjithë do të ndjehen të respektuar dhe të aftë që të provojn mënyra të reja të mësimi. Në fund, ai thekson se ora e matematikës gjithashtu duhet të jetë zbavitëse.

Më tutje Kiti e angazhon klasën në ushtrime serike për ndërtimin e bashkësisë dhe vazhdon me ata gjatë tërë gjysëmvjetorit. Qëllimi i tij është që t'ju ndihmon nxënësve të njihen në mes veti si personalitete me prioritete, nevoja dhe vlera të ndryshme. Fillon me ushtrim në klasë që u ndihmon të gjithve ti mësojnë emrat e gjithë anëtarve të grupit. Pastaj u lejon nxënësve që mes veti të bëjnë intervistë dhe të paraqesin atë që bën intervistë para gjithë grupit. Aktivitetet tjetër për ndërtimin e bashkësisë që ai shfrytëzon është loja "Loja për zbulimin e misterit" në të cilën ai sejcilit person në grup i'a zbulon pjesë të informacioneve të nevojshme që të zgjidhet misteri, që mund të zbulohet vetëm me pjesëmarje grupore dhe dëgjim aktiv. Aktivitete e këtilla fillojnë me stimulimin e procesit gjatë të cilit me mbledhjen e personave formohet bashkësia, duke krijuar ndjenjë të afërsisë dhe konfortsisë dhe duke ofruar ushtrime të shkathtësive që janë të patjetërsueshme për funksionimin efikas të grupit që japin mbështetje. Kiti gjithashtu bën me dije se nxënësit do të ndihmojnë për caktimin e rregullave:

Në fillim të vitit bënim "stuhi të ideve" për atë se cila rregull do të jetë e patjetërsueshme për të gjithë ne që t'i arrijm qëllimet tona. Vendosëm se nuk mund disa të flasim në të njëjtën kohë, por vetëm një person. Për këtë arritëm konsensus që në ditën e parë.

Bisedimet për përmbajtjen e vendimit dhe procesit gjatë cilit ishte sjellur deri sa e dakordonim këtë rregull si hap i rëndësishëm, nuk ishte e lehtë mori kohë të caktuar. Kiti u ndihmonte nxënësve që të zhvillojnë durimin dhe respektin e ndërsjell i pashmangshëm për arritjen e kësaj rregulle. Më tepër u mbështet në teknikat për mësim kooperativ që t'u ndihmojnë nxënësve që të zhvillojnë ndjenjën e lidhjes dhe aftësinë të punojn së bashku, të cilat janë shumë të rëndësishme për procesin që don ta krijoj. Fillon me punë të shpesht në grupe të vogla, duke ndërtuar gradualisht nga çiftet dhe treshet drupe naga katër ose pes anëtarësh. Nëpërmjet kësaj, ai i plotëson qëllimet, aftësit dhe qëndrimet të patjetërsueshme për punën efikase grupore.

Që ta bëjë në model besimin e tij në rëndësinë e lidhjes në mes njerëzve në procesin e mësimi, Kiti fillon për çdo orë duke u munduar të përshëndes sejcilin nxënës veçmas. E fillon sejcilën orë me kohë të shkurtë për "lidhjen", gjatë kësaj kohe nxënësit hynë në biseda për ngjarjet dhe problemet në jetën e tyre në shkollë dhe jasht saj. Një nxënës e pasqyron vlerën e kësaj: "Kuptova se secili i ka problemet e njëjta të cilat i kam unë, dhe kjo ndihmon disi që të më përmirësohet dita".

Kiti gjithashtu i involvon nxënësit në zhvillimin e sistemit të vlerësimit për lëndën. Nxënësit zhvillojnë sisteme inovative ndonjëherë edhe sisteme të komplikuar të vlerësimit. Për shembull:

Në njërin prej orëve tona vendosëm të japin dhurata të posaçme për grupin që do t'i meriton. Nëse secili anëtar nga grupi e kuptojn materialin dhe i bëjnë detyrat e shtëpisë, do të fitojn pikë plotësuese.



Kjo metodë e vlerësimit është e ndryshme prej klasës në klasë, por ajo që është e përbashkët për numërin më të madh të klasave është se kërkohet nga nxënësit që rregullisht (më së shpeshti çdo javë të dytë) të japin vlerësimin për vetën dhe për klasën, dhe të marin pjesë në formimin e notës së vet, më së shpeshti nëpërmjet ndonjë forme të bisedimeve me Kitin.

Qëllimi i tij çdoherë është të lëviz kah pika ku nxënësit jo vetëm që do të marin pjesë në zhvillimin e rregullave dhe metodave për vlerësim, por gjithashtu do të ndajnë përgjegjësinë për stimulimin e aktiviteteve gjatë kohës së orës. Megjithatë e marur në përgjithësi, ai e merr përgjegjësinë për paraqitjen e materialit të ri, për parashtrimin e pyetjeve, për prezentimin e ideve të reja dhe hulumtimin mes tyre. Ai e zhvillon kuptimin e dukurive që qëndrojnë pas proceseve dhe i sqaron problemet - shembujt me theksimin e pikave kryesore.

Në përsëritjen e problemeve dhe materialit pasi janë paraqitur idetë dhe pasi janë përpunuar ata, Kiti e shikon shansin më të mirë që t'i inkorporon nxënësit në udhëheqjen e sesioneve për zgjedhjen e problemeve dhe në punën e përbashkët si grup e udhëhequr nga nxënësit. Fillon me dhënien e shembujve si të udhëhiqet grupi nëpërmjet problemeve matematikore. Në mesin e vitit nxënësit fillojnë vet ti udhëheqin orët e tyre;

Më vonë gjatë vitit pyes a don dikush ta udhëheq orën, që do të thotë ata do të jenë përgjegjës për mbajtjen e drejtimit, mbledhjen e ideve, vendosjen sa probleme do të zgjedhin dhe involvimin sa më tepër që është e mundur të nxënësve. Ata inicojnë edhe bisedë rreth problemeve.

Kiti i përshkruan llojet e interakcioneve në mes nxënësve që paraqiten në klasë të këtilla:

Fëmijët i parashtrojnë pyetjet e tyre, a nxënësi i shkruante në tabelë pastaj i ndihmojnë njëri tjetrit. Kur nxënësi në tabelë do të ngecte, do të rrotullohej dhe do të thoshte: “Ngeca a mund të më ndihmoni?” Dhe dikush thoshte “Po, vepro si vijon: pjesëtoj të dy anët me numrin e njëjtë”. “Oh, po do të thoshte nxënësi në tabelë, dhe ato do të vazhdonin më tutje. Disa herë kjo më ishte shumë prekëse, fëmijët do të ndaleshin, arrinin deri në gjysëm dhe thonin: “Nuk mundem” dhe shkonin përsëri në vend, kurse klasa do të thoshte: “Jo,jo, ri në tabelë, ne të gjithë mundohemi me problemet. Kjo është “mënyra të mësoh”.

Kiti vazhdonte të luante rolin në udhëheqje dhe fokusim të klasës. Për shembull, nxënësit mbështeteshin në mbikqyrjen e tij, këshillimin dhe mbajtjen e shpejtësisë me të cilën zhvillohej mësimi. Ata pyetnin kur ai dëshiron të ligjëroj temë të re. Kur ato e udhëheqin klasën njëri prej roleve kryesore të tij ishte të jetë burim i informacioneve. Për shembull një ditë një nxënëse e udhëhiqte sesionin për zgjedhjen e problemeve, u bë e qartë se klasa nuk mund ti arrinte qëllimet për atë ditë. Kur mbetën edhe 5 minuta Kiti i`u afrua nxënësës dhe ajo i propozoi disa mënyra që mund të adaptohet në situatën e krijuar. Ai u pajtua dhe i ofroi këshillë për atë si ta mbaron orën. Pastaj nxënësja e mbaroi rolin e saj si lider i klasës.



Kur klasa vet e udhëheq procesin e zgjedhjeve të problemeve, Kiti gjithashtu shërben si burim i përmbajtjes e cila duhet të mësohet. Derisa punojnë në problemet, ai i inicon të shfrytëzojnë dituritë e tyre para se ti drejtohen atij. Por në mes tjerave nëse grupi me të vërtetë ngec, ai është në disponim. Nxënësit përshkruhen se “së pari ne do të mundohemi të gjejmë a mund dikush nga klasa ta kupton, nëse nuk mundet, ai do të na udhëheq drejt zgjedhjes së problemit. Kjo është mirë sepse prej secilit kërkon të jep ide dhe të mendojnë”. Më së shpeshti, nxënësit e kuptojnë procesin që ai e stimulon, dhe në fakt shpesh vin në përfundim se mund të zgjedhin problemet mes veti, pa ndihmën e tij.

Niveli i besimit, respektimi i ndërsjellë dhe rrezikimi që paraqiten gjatë disa orëve janë impresive, siç është rasti nga ora e algjebres në një klasë:

Në fillim të orës një nxënës pyeti kush do të bëhet ndihmës. Një nxënës tjetër propozoi se duhet ndonjë i ri të provoj. Një nxënës u përgjigj duke sugjeruar një nxënës konkret i cili nuk e ka bërë këtë më parë, që të marrë rolin. Ai mendonte se ende është i papregatitur dhe këtë i'a bëri me dije. Më në fund një nxënës tjetër tha:”Unë mendoj se do të jesh ndihmës i shkëlqyeshëm, pse nuk e provon?”.Nxënësi që dyshonte u pajtua ta provon. Unë atëherë e mbikqyra ndihmësin më të mirë që kam pasur rast ta shiqoj gjatë opservimeve të mia.

Kiti sqaroi pse mendonte se këto forma të dinamikës grupore janë aq të rëndësishme:

Mendoj se ky lloj i punës së përbashkët dhe ajo mënyrë e lidhjes në mes veti është diçka që nuk ndodh kur mësuesi është i autorizuar për të gjitha, kur i posedon përgjigjet, kur prej ndihmës së tij varet secili nxënës a do ta kupton a jo. Edhe në orët ku ka atmosferë të sigurt dhe nxënësit mund të kërkojnë nga mësuesit gjithçka dëshirojnë, mungon diçka që është shumë me rëndësi. Fjala që mund të përdoret për sqarimin çfarë është bashkësia, por kjo shkon edhe më thellë, depërton në lidhjen njerëzore. Mendoj se struktura e orës, ku mësuesi nuk është kryesor dhe kur nuk e ka gjithë pushtetin, ofron më tepër pushtet... në mes nxënësve dhe mësuesit... problemet që paraqiten janë shumë real. Ato janë pyetje me të cilat njerëzit ballafaqohen gjithmonë, pyetje për besimin, respektimin dhe mbështetjen.

Kiti realizon shumë nga qëllimet e tij. Natyra e autoritetit të tij shëndrohet prej autoritetit të pozicionit ose rolit të paraparë - autoritet i bazuar në mbështetje institucionale dhe kontroll sanksionuese mbi nxënësit - në autoritet të ekspertit. Nxënësit fillojnë ta respektojnë dhe ta dëgjojnë, jo pse e kanë patjetër por përshkak se e vlerësojnë atë që ai e din dhe përvojën e tij. Kjo ndodh së pari përshkak të asaj se ai i involvon nxënësit në procesin e sjelljes së vendimeve dhe ligjirimit dhe së dyti, përshkak të asaj që mundohet rreth kualitetit të mardhënieve që vendosen mes nxënësve dhe në mes tij dhe nxënësve. Kiti e respekton votën e tyre dhe karakteristikat e tyre dhe ata i'a kthejnë. Kjo është mardhënia ku ekziston ndërsjellshmëria.



Derisa mësuesit çdoherë kanë pushtet mbi nxënësit derisa punojnë në shkollat tradicionale, Puna e Kitit tregon mundësinë për bartjen e këtij pushteti dhe krijimin e bazës më ndryshe për mësim dhe për ndërtimin e marrëdhënies mësues nxënës. Një nxënës e shpreh përvojën e tij nga orët me Kitin, duke sugjeruar për benifitet kryesore të autoritetit të rikonstruktuar:

Unë nuk e di kur do të më duhet të dij atë se kur dy vija paralele priten me tranzverzalen, atëherë këndet e brendshme të tyre janë të njëjta ose mbledhja e këndeve në trekëndësh është 180 shkallë. Por mendoj se mësova më tepër nga matematika se në orët e matematikës. Mësova se si të bashkëpunoj me njerëzit tjerë, si ti paraqes problemet para grupit dhe të kërkoj këshillë prej tyre. Mësova si të punoj me njerëz tjerë në bashkësi në të cilën të gjithë janë të njëjtë - si të mospajtohem me mendimin e dikujt, kurse ndërkohë të mos grindem duke shfrytëzuar fjalët budalla, i pa mprehtë, ose idiot. Matematika më mësoi si të jem i përgjegjshëm ndaj grupit të njerëzve, ti respektoj dhe të shpresoj se edhe ato më respektojnë mua. Ora e matematikës ishte në fakt e para ku njerëzit dëgjuan atë që dëgjova unë, Stive Sho, e kisha për të thënë.

Ajo që Stiv Sho e mësoi në orët e Kitit është në fakt shkathtësi dhe qëndrime të cilat janë të patjetërsueshme për funksionim efikas dhe me përgjegjësi në demokraci...



KUBI

<p>Përshkruaj</p> <p>Pjesën hyrëse të orës me mësuesin Kit</p>		
<p>Krahaso</p> <p>Orët e Kitit me orët tua. Ku janë të ngjashme, kurse ku dallohen?</p>	<p>Asoco</p> <p>Lirshëm, çfarë të vjen ndër mend kur e lexon tekstin? Në çka të çon të mendosh?</p>	<p>Analizo</p> <p>Rolin e mësuesit Kiti si autoritet i ekspertit.</p>
<p>Zbato</p> <p>Çfar mund të zbatosh në orët tua nga ajo që lexove?</p>		
<p>Argumento për dhe kundër</p> <p>Mer qendrim dhe argumento çfarë të pëlqeu, kurseçfarë jo në tekst.</p>		



Nivelet e pyetjeve

1-DITURIA

FAKTET	KUJTIMI	NJOHJE
Kush	Ku	Përshkruaj kush
Çka	Si definohet	Çka është më e mirë
Pse	Sa	Bëre zgjedhjen
Kur	Çka do të thotë	selekto

2-KUPTIMI

RITREGIM	KOMENTIM	KRAHASIM
Çka do të thotë ajo	Klasifiko	A është njëloj si...
Thuaj me fjalët tua	Gjyko	Cakto definicionin më të mirë
Jep shembull	Përfundo	Çka do të ndodhë nëse...
Shpjego shkurtimisht	Trego	Sqaro çfar ka ndodhur
Trego me një fjalë	Poenta	Sqaro çka është menduar
Cila pjesë nuk përgjigjet	Përgjigju	Lexo grafikonin, tabelën
Cilët kufizime i ka	Përkthe	Paraqit me vizatim, këngë
Çfar pritje ka	Nënvizo	Kjo paraqet...
Çka është më e mundshme	Sumo	Është e vërtetë sepse...
Çka thonë ata	Selekto	Cila deklaratë e përmban idenë themelore
Çka mund të jetë ajo	Sqaro	
Çka duket nëse	Paraqit	

3-ZBATIMI

SITUATË E RE OSE E PANJOHUR PËR NXËNËSIT
Parashiko çka do të ndodh nëse
Zghidh deklaratën më të mirë e cila mund të zbatohet
Selekto
Sill gjykim për efektet
Cili do të jetë rezultati
Sqaro
Trego çka do të ndodhë
Trego si, kur, ku, pse
Trego çfarë ndryshimi do të ndodhë
Identifiko rezultatet



4-ANALIZA

ANALIZA E PJESËVE		
Dallo	Cili është funksioni...	Cil është tema kryesore dhe idetë anësore
Identifiko	Cilat janë faktet	Cilat janë mospajtimet, variacionet
Cilat parashikimet, hipotezat	Cila deklaratë është më adekuate	Cila ndarje është shfrztëzuar
Cili është motivi në pajtueshmëri me	Çfarë beson autori	Cilat teknika të
Cilat përfundime	Trego pikën e kënvëzhgimit	Si është relacioni me...
Bëre dallimin	Cila ide drejton në përfundim	
Cila është baza	Deklarata themelore janë...	

5-SINTEZA

THYERJA NË PJESË, FORMA		
Formëso	Si do të testohet	Pregadit
Trego	Propozo alternativë	Krijo
Bëre	Mbizotëro këtë	Formulo teorinë
Puno	Planifiko	Si do të jetë më ndryshe
Luaj	Dizajno	Bëre rregullën
Zgjidh		Zhvillo

6-EVALUIMI

SHFRYTËZIMI I KRITERIUMEVE DHE SQARIMEVE	
Vlerëso	Cilat janë besimet e gabuara
Gjyko	Çka është më e rëndësishme, më e mirë, më logjike, joadekuate
Kritiko	Gjeji gabimet
Mbro	Në cilën bazë
Krahaso	Duke e shfrytëzuar teoritë e diskutuara, krahaso



Plan individual për hulumtim

Emri dhe mbiemri:		
Tema:		
Roli në ekip:		
Çka duhet të bëj?	Korniza kohore	Me cilin të bashkëpunoj?
Ku dhe si të gjejë informacionet?	Me cilat bariera mund të ballfaqohem?	Si do t'i tejkaloj?
Shënim:		



Plani grupor i hulumtimit

Tema:	
Qëllimet:	
Rolet e anëtarëve në ekip:	Detyrat dhe korniza kohore:
Burimet - resurset:	Pengesat e pritura:
Shënim:	




Raport periodik

Raporti nr. 1 (2, 3, 4.....)
Aktivitetet e ndërmara:
Rezultatet e arritura:



Çka është shëndeti? Çka është njeri i shëndetshëm? Çka është shkollë e shëndetshme? Si mund të avansohet shëndeti në shkollë?





Personi A

Dëgjo sa të mundesh me vëmendje derisa tjetri flet, kushtoi vëmendje të plotë. Kjo me siguri të bën që shikimin ta drejtosh nga bashkëbiseduesi e jo të shikosh për reth. Trego që me të vërtetë e dëgjon në mënyrë sa më të natyrshme që është edhe për ty. Ndoshta dhe me reaksione të zëshme bie fjala: aha, të kuptoj, me të vërtetë etj.

Personi B

Fare nuk do të dëgjosh me vëmendje, derisa tjetri flet, bëj diçka nga këto shembuj : shiko përreth në klasë dëgjo çka flasin çiftet tjera, lidhi lidhëset e këpucëve, bëhu sikur kontrollon diçka në çantë, luaj me sendet mbi bankë, ndërprite bashkëbiseduesin etj.

Ndihma e nxënësve të bisedojnë për problemet e veta

Respektimi

Mardhënie pozitive pa kusht

Nuk miratohet sjellja, por personaliteti është O.K.

Dhënia e një pjese të kohës së vet

Kujdes pozitiv

Dëgjim aktiv

Të mos ndërpritet biseda e personit tjetër

Parashtrimi i pyetjeve (të hapura)

Të mos kritikohet dhe gjykohet

Shfrytëzimi i gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme

Empatia

Vendosja në vend të tjetrit

Qeshu kur bashkëbiseduesi qeshet, trego gjeste të fytyrës të mos kënaqësisë kur edhe bashkëbiseduesi është i pakënaqur

Reflektimi i ndjenjave "Do të thotë ndjehem shumë i hidhëruar", "Tingëllon i lumtur"

Ndaj ndjenjat e tua nëse janë relevante, por kujdesu të mos e tërheqësh të gjithë vëmendjen në vete dhe të marish shumë kohë.

Ndershmëria (origjinaliteti)

Bëhuni të ndershëm dhe jep mesazhe konzistente në nivel verbal dhe joverbal

Fol në mënyrë adekuate për vetën (mos trego diçka që nuk je)-mos u paraqit si dikush që nuk je

Ndaj ndjenjat në mënyrë të rregullt

Mos premtu diçka që nuk mund t'a plotësosh

Plotësoje atë që e ke premtuar



Ajo që më bën të zemëruar është _____

Shkruaj:

Ajo që më bën të hidhëruar është _____

Shkruaj:

Ajo që më bën ziliqar është _____





Shkruaj:

Ajo që më shtyn të urrej është _____





Shkruaj:



Fletë punë



Hidhërim



Urrejtje

Armiqësi

Mlllef



Mënyra të miratuara për shfaqjen e agresivitetit	Mënyra të pa miratuara për shfaqjen e agresivitetit
<p>Plotëso listën:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të shkruaj në një faqe çka më bën të hidhëruar, ta ndrydhi dhe ta hudh. 2. Ta shutoj topin të cilin e emrova me emrin e atij që më bën të zemëruar. 3. Kur ndjej urejtje të mar një jastëk dhe ti bij me fuqi 4. Të numroj gjer më dhjetë gjersa më kalon hidhërimi. 	<p>Plotëso listën:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ta thej gotën mbi tavolinë kur jam i zemëruar 2. Ti hudh këpucë e motrës kur jam gjeloz 3. Ti gris pantollonat e vëllaut kur e urej



DIÇKA TJETËR

në kodër me erë
në vetmi
pa asnjë askund që shok mund ti bëhet
jetonte diçka tjetër

E dinte se është ajo që është, se të gjithë e thonin këtë.

Kur orvatej të ulej me ata
Ose të shetis me ata
Ose t'ju bashkohet në lojë
Çdo herë merte përgjigje të njëjtë:

“Na fal. Nuk je sikur ne.
Ti je diçka tjetër.
Nuk na takon aspak.”

Diçka tjetër u mundonte shumë
Të ngjajë me të ndryshmit prej tij.

Duke qeshur thoshte “Tungjatjeta”, si ata i'a kthenin përgjigjen.

Kur e lejonin të luante lojrat e tyre.

E mbante mëngjesin në qesen, sikurse ata që kanë zakon.

Por kot.

Nuk ngjante me ata, as që fliste sikur ata.

Nuk e vërente atë që e vërenin ata.

As që dinte të luante si ata.

As që mos të flasim për ushqimin

“Nuk i takon kësaj”, thërisnin.
“ Nuk je sikur ne. Ti je diçka tjetër.”

Diçka tjetër u tërhoq në shtëpi. Derisa përgatiteshe për gjumë u dëgjua trokitje në derë.

Diçka tjetër qëndronte në prag të derës.
“Tung”. Tha.”Më vjen mirë që të njoha. Mund të hyj?”
“Pardon?” tha diçka tjetër



“Je i mirëseardhur”, tha krijesa.
Ja dha shputën e tij ose mund të ishte pendë.

Diçka tjetër shiqonte në shputën.
“Mendoj se e ke gabuar vendin”, tha.

Krijesa lëkundi kokën. “Jo, aspak. Vendi është i përkryer. Shiqo!”

Dhe derisa Diçka tjetër kuptoi se çfarë ndodh, krijesa hyri brenda....
.....dhe ul atje te ushqimi i tij.

“Të njohë prej ndokund”, pyeti Diçka tjetër i hutuar.
“A më njeh?, u buzëqesh krijesa. “Kuptohet se më njeh.
Shikom mirë. Vetëm përpara!”

Diçka tjetër shiqonte.

U rrotullua rreth krijesës para mbas dhe mbas para.
Nuk dinte çfarë të thoshte, dhe heshti.

“A nuk e shiqon?, bërtiti krijesa.
“Unë jam i njëjtë sikur ti! Ti je diçka tjetër,
EDHE UNË JAM NJËJTË SI TI!”
Edhe njëhërë ia dha shputën dhe qeshi.

Diçka Tjetër u gjend në huti, dhe nuk mund ta kthente buzëqeshjen. As që ta pranonte shputën.

“Njëjtë sikur unë?”, tha.”Ti nuk je sikur unë. Në fakt, ti nuk ngjan në asgjë që unë kam parë. Më fal, por ti definitivisht nuk je lloji IM i diçka tjetër.”
Shkoi deri te dera dhe e hapi. “Natën e mirë.”

Krijesa ngadalë e tërhoqi shputën.
“Ah”, tha.
Dukej disi i mërziur dhe i vogël.

E përkujtoi Diçka Tjetër në diçka, por nuk i vinte në mend se në çka.

Dhe gjersa mundohej të kujtonte, krijesa iku

Përnjëherë Diçka Tjetër iu kujtua.
“Prit”, bërtiti.”Mos shko”.

Më shpejt që mundi vrapoi pas krijesës.
Kur e arriti, fort ia shtrëngoi shputën.
“Nuk je sikur unë, por nuk është me rëndësi, mund të rish me mua nëse dëshiron.”
Dhe krijesa u kthye.



Prej atëherë e këndej, Diçka Tjetër kishte diçka që mund ta kishte shok.

Duke qeshur, u përshëndetën me “Tungjatjeta”.

Vizatuan, fotografuan...

Secili luante lojrat që tjetri i dinte dhe i dëshironte, ose deri diku mundoheshin.

Ushqeheshin njëri pranë tjetrit.

Ishin të ndryshëm, por kishin mirkuptim.

Por kur u shfaq Diçka me pamje me të vërtetë të çuditshme , ato nuk i thanë se nuk i ngjan atyre dhe se nuk do të kyçet në shoqërinë e tyre.

U larguan dhe menjëherë i bënë vend.



Vërej ngjajshmëri dhe dallime

Anëtarë të familjes	Tre ngjajshmëri në mes meje dhe anëtarëve të familjes sime 1. 2. 3.	Tre dallime në mes meje dhe anëtarëve të familjes sime 1. 2. 3.
Shokët	Tre ngjajshmëri në mes meje dhe shokëve të mi 1. 2. 3.	Tre dallime në mes meje dhe shokëve të mi 1. 2. 3.
Njerëz me besim tjetër fetar	Tre ngjajshmëri në mes meje dhe njerëzve me besim tjetër fetar 1. 2. 3.	Tre dallime në mes meje dhe njerëzve me besim tjetër fetar 1. 2. 3.
Njerëz të vendeve tjera	Tre ngjajshmëri në mes meje dhe njerëzve të vendeve tjera 1. 2. 3.	Tre dallime në mes meje dhe njerëzve të vendeve tjera 1. 2. 3.



Vlerësimi individual

Emri	Nota
Jono Oko	
Hai	
Cao Me	
Vu	
Sing Sing	

**Paraqitja tabelare e vlerësimit të secilit nxënës veçmas
(Duhet të bëhet në fletë të madhe letre dhe paralelisht secili të mban evidencë)**

	Jono Oko	Hai	Cao Me	Vu	Sing Sing
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
16.					
17.					
Gjithsej					



JONO OKO DHE HAI

Jang - ce është lum i madh dhe i gjatë, i cili ka shumë dredha, kurse ka disa ura ku mund të kalohet mbi lumë.

JONO OKO jeton në bregun e lumit. Ajo është 17 veçare dhe është marrëzisht e dashuruar në HAI-n i cili jeton në anën tjetër të lumit. Një ditë JONO OKO vendosi ta viziton të dashurin dhe për këtë arsye shkoi deri te CAO ME që ta lut që ta çon në anën tjetër (të kundërt) të bregut. Edhe pse CAO ME ka edhe barkë, ai nuk donte ta çonte JONO OKO.

JONO OKO nuk heq dorë për këtë arsye shkoi deri te VU dhe e luti që ta çon në anën tjetër të lumit. VU u pajtua, por me një kusht që JONO OKO të kaloj natën me atë dhe të nisen herët në mëngjes. Dhe kështu ndodhi. JONO OKO aq shumë dëshironte ta shihte HAI sa që u pajtua të kalonte natën me VU dhe herët në mëngjes ai e çoi në anën tjetër të bregut.

JONO OKO ishte shumë e lumtur kur e vërejti HAI, vrapoi në krahët e të dashurit dhe i tregoi çfarë probleme kishte për të arritur deri te ai. HAI e përzuri prej vetes.

JONO OKO e mërzhitur shëtiste pranë bregut të lumit, duke luftuar me lotët. Atëherë e takoi Sing-Sing. Sing-Sing e pyeti pse qan dhe është e mërzhitur. Jono Oko i tregoi tregimin e saj.

Sing-Sing shkoi te HAI dy herë i ra në fytyrë dhe nuk i tha asnjë fjalë.

VERZIONI I TREGIMIT KA TË BËJË ME KONTEKSTIN

JONO OKO ka 17 vjet dhe është nxënëse në gjimnaz, kurse HAI është mësuesi i saj i martuar i lumtur. CAO ME ligjiron në të njëjtën shkollë. HAI është kolegë i tij. Kurse VU është gjysh i JONO OKO i cili gjatë nuk e ka parë mbesën e tij të dashur dhe i cili pi çaj duke biseduar tërë natën. SING SING është vrasës dhe psikopat. Është vetëm fat që HAI i ka ra më shuplakë.



6 hapa për zgjedhje (transformim) të konflikteve:

1. Identifikim të nevojave (çka është ajo që ju duhet, ose dëshironi?). Çdo person në konflikt duhet ti përgjigjet kësaj pyetje, pa mos e akuzuar personin tjetër.
2. Definim të problemit (Çka mendoni çka është këtu problemi?) komplet klasa mund të ndihmojë të jepet përgjigje e cila i kyç nevojat e të dy anëve, pa akuzime. Personat që janë në konflikt patjetër të pajtohen me definicionet.
3. Stuhi idesh për zgjedhjet e shumta të mundshme (i cili mund të paramendojë mënyrë me të cilën mund të zgjidhet ky problem?) Çdonjëri në klasë mund të ofrojë përgjigje. Të gjithë duhet të jenë të shënuar, pa koment, notim, gjykim. Qëllimi i këtij hapi është të arrihet në zgjidhje të më shumta.
4. Evaluim i zgjidhjeve (a do të ishit të lumtur me këtë zgjidhje?) çdonjëra anë në konflikt e shikon listën e zgjidhjeve të mundshme dhe thotë kush mund të jetë e pranueshme për atë-e, a kush jo.
5. Sjellje të vendimit për zgjidhjen më të mirë (a pajtoheni të dy anët me këtë zgjidhje? A është problemi i zgjidhur?) vërtetim se të dy anët pajtohen dhe u jepet mirënjohje për mundin e dhënë për zbulim të zgjidhjes.
6. Kontroll të asaj si do të funksionojë zgjidhja (aj të flasim përsëri së shpejti që të shohim se problemi është i zgjidhur)duhet të bëhet plan për ate si të evaluohet zgjidhja. Evaluimi mund të bëhet për një orë ose ditën tjetër, javën, mvarësisht prej asaj si është natyra e konfliktit dhe moshja e personave të kyçur në konflikt.



- Ајдуковиќ, Д. (2000). *Зајакнување на децата-Психосоцијална помош во тешки околности*. Скопје: Малинска
- Бешка, В. (1999). *Почитување на разликите*. Скопје: НУБ
- Fountain, S. (1995). *Education for Development*. London: Hodder & Stoughton
- Фаунтејн, С. (1993). *Така е праведно!-Практичен водич во учењето за Конвенцијата за правата на детето*. Одделение за образование за развој, УНИЦЕФ
- Holzman, L. (1997). *Schools for Growth-Radical Alternatives to Current Educational Models*. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates
- Holzman, L. (2000). *Performative Psychology An Untapped Resource for Educators*. New York: East Side Institute for Short Term Psychotherapy
- Јанаков, Б. (1997). *Современи теории за личноста*. Скопје: Еин-Соф
- Lobman, C. Draft paper. *Improvisation: Postmodern Play for early Childhood Teachers*
- Laura, E. Berk. *Vygotsky's Theory: The Importance of Make – Believe Play*. Illinois State University
- Огњеновиќ, В. (2003). *Здраво да сте: Радионице за деца*. Београд: Здраво да сте
- Ognjenović, V. и Škorc, B. (2003). *Evaluacija Zdravo da ste programa*. Beograd: Zdravo da ste/Hi Neighbour
- Петковски, К. и др. (2005). *Проектни активности*. Скопје: НУБ
- Simovska, V.(2004). *Student participation: a democratic education perspective – experience from the health-promoting schools in Macedonia*. Health Education Research Theory & Practice, Vol.19 no.2 2004 p.198-207
- Симовска, В. и Костарова-Унковска, Л. (1998). *Образование за демократија со демократија-учество на учениците, компетентност за акција и промена во процесот на образование*. Скопје: Психолошко советувашиште за млади/Филозофски факултет,
- Симовска, В. и Чешларов, М. (2001). *Гласот на учениците-Прикази на примери од Македонската мрежа на училишта што го унапредуваат здравјето*. Скопје: Биро за развој на образованието
- Смајк, П. (2000). *Слушање за подобро здравје-Здравствена едукација преку правилно разбирање на пораките*. Скопје: Центар за психосоцијална и кризна акција – ЦПКА
- Steele, J.L., Meredith, K.S., & Temple, C. (1997). *Со читање и пишување до критичко мислење-Прирачник*. Скопје: Фондација институт отворено општество Македонија
- Унковска, Л. (1997). *Образование за развој*. Скопје: Психолошко советувашиште за млади.
- К. Кејв и К. Ридел (2003) *Нешто Друго*, Темплум, Скопје
- http://web.archive.org/web/20010708032422/www.j51.com/tatyana/Vygotsky_Appr.ht
- http://www.ncsu.edu/felder-public/Cooperative_Learning.html
- <http://www.euro.who.int/Document/e87579.pdf>
- <http://www.vcu.edu/cte/activelearningtechniques.html>
- <http://www.calstatela.edu/dept/chem/chem2/Active/>
- <http://aee3200.ifas.ufl.edu/techniques.html>
- <http://frank.mtsu.edu/~phil/courses/Leon/learn.html>
- <http://home.capecod.net/~tpanitz/>
- <http://www.calstatela.edu/dept/chem/chem2/Active/>
- <http://www.edb.utexas.edu/pbl/tips/question.html#hots>



Издавач: **Алгоритам Центар**, Едукативен Центар
Скопје – Република Македонија
www.algoritamcentar.edu.mk; e-mail: **acentar@t-home.mk**
Тел. број **(02) 3116-750**

Директор на Алгоритам Центар: **Марина Божинова**

Автори:

Ана Блажева
Жанета Чонтева

Соработници:

Марина Божинова
Весна Шуркова

Година на издавање: 2010

Технички уредник и дизајн: **Алгоритам Центар**
Марјан Србиновски, Зоран Зивчевски

Печати: Маринг – Скопје



Министерство за образование и наука
Биро за развој на образованието
Проект за модернизација на образованието